



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 gusht 2024
Nr.ref.: AGJ 2513/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO248/23

Parashtrues

**Ferat Shala dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit
të Republikës së Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të
Qëndrueshme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), përkatësisht: Ferat Shala, Mërgim Lushtaku, Hisen Berisha, Eliza Hoxha, Ariana Musliu Shoshi, Ganimete Musliu, Isak Shabani, Hajdar Beqa, Floretë Zejnullahu dhe Rashit Qalaj, të cilët përmes autorizimit i përfaqëson Ferit Pula (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës ose deputetët parashtrues).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar), i miratuar me Vendimin [nr. 08-V -620] e 19 tetorit 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në përputhshmëri me nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] dhe nenin 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Në kontekst të efekteve të parashtrimin të kërkesës përkatëse në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, theksojnë: *“me kërkesën për zbatimin e nenit 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, për sa i përket efektit pezullues ex-lege të zbatimit të ligjit, nëse i njëjti kontestohet në Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 tetor 2023, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan përmes postës kërkesën në Gjykatë.
7. Më 8 nëntor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KO248/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe kolegjin shqyrtues përmes Vendimit [Nr. KSH. KO248/23] të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi Peci (anëtarë).
8. Më 21 nëntor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Në po atë datë, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit; si dhe (iii) zv. Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, me sqarimin që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 (Afati) të Ligjit, *“në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Gjykata, bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit dhe praktikën e saj gjyqësore, rikujtoi se kjo dispozitë nënkupton që Ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës, lidhur me çështjen e ngritur pranë saj. Kryetarit të Kuvendit, gjithashtu, iu kërkua që të njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, nëse kanë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, përkatësisht deri më 6 dhjetor 2023.

10. Po ashtu, në të njëjtën datë, për regjistrimin e kërkesës Gjykata njoftoi (i) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); (ii) Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Avokati i Popullit); dhe (iii) Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme: MFPT), duke i informuar se mund t'i paraqesin në Gjykatë komentet e tyre lidhur me kërkesën e parashtruar, nëse kanë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, përkatësisht deri më 6 dhjetor 2023.
11. Më 30 nëntor 2023, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ia dorëzoi Gjykatës dokumentet vijuese: 1. Projektligjin për investime të qëndrueshme, të proceduar nga Qeveria në Kuvend më 19 janar 2023; 2. Raportin e Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, të 14 shtator 2023; 3. Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit funksional Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për shqyrtimin e parë të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, 14 shkurt 2023; 4. Vendimin [nr. 08-V-532] e 3 majit 2022 të Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, 14 shkurt 2023; 5. Procesverbalin e Seancës Plenare të Kuvendit të 23 shkurtit 2023; 6. Pjesë nga transkripti i Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-209 për investime të qëndrueshme, të 23 shkurtit 2023; 7. Raporti me amendamente i Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për komisionet e përhershme lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, të 10 tetorit 2023; 8. Raporti me amendamente i Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, së bashku me raportet e komisioneve të përhershme, të 17 tetorit 2023; 9. Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, të 10 dhe 17 dhjetorit 2023; 10. Përgjigje e Komisionit Evropian për iniciativat për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, e 1 shkurtit 2023; 11. Vërejtje dhe sygjerime të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, lidhur me Projektligjin për Investime të Qëndrueshme; 12. Punim Hulumtues i Drejtorisë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të korrikut 2023; 13. Transkripti i dëgjimit publik i Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, të 16 qershorit 2023; 14. Vendimin [nr. 08-V-620] e 19 tetorit 2023 të Kuvendit për miratimin e Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme; 15. Pjesë nga Procesverbali i seancës plenare të Kuvendit të 19 tetorit 2023; 16. Pjesë nga Transkripti i Seancës Plenare i shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr.08/L-209 për investime të qëndrueshme, nr. 08-V-620, të 19 tetorit 2023; dhe 17. Ligji nr. 08/L-209 për investime të qëndrueshme të 19 tetorit 2023.
12. Më 6 dhjetor 2023, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, në emër të Qeverisë së Kosovës, dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës.
13. Po ashtu, në po atë ditë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, përmes deputetes, Mimoza Kusari-Lila, dorëzoi në Gjykatë përgjigje në kërkesën e parashtruesve të kërkesës.
14. Më 20 dhjetor 2023, lidhur me komentet e pranuar, Gjykata njoftoi (i) Presidenten e Republikës; (ii) Kryetarin e Kuvendit; (iii) Kryeministrin; (iv) Institucionin e Avokatit të Popullit, (v) MFPT-në, si dhe (v) parashtruesit e kërkesës.
15. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
16. Më 20 qershor 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtari raportuese dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në po

të njëjtën ditë, Gjykata vendosi njëzëri: (i) të shpallë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë që nenet 21 (Këshilli), 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit), 52 (Dispozitat kalimtare) dhe 53 (Shfuqizimi) të Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2 të nenit 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës; (iii) të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme; (iv) të shpallë që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje; (v) ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 3 maj 2023, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr.08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nëpërmes Vendimit [Nr.08-V-532].
18. Më 19 tetor 2023, Kuvendi në Seancë Plenare miratoi në leximin e dytë me Projektligjin nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit të kontestuar në tërësinë e tij, duke pretenduar se Ligji i kontestuar është në kundërshtim me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], si dhe nenet 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.
20. Në lidhje me pretendimet e lartcekura, parashtruesit e kërkesës paraqitën argumente përkitazi me: (I) pranueshmërinë e kërkesës; (II) përmbajtjen e Ligjit të kontestuar; dhe (III) vendosjen e masës së përkohshme. Në vazhdim, Gjykata do të paraqesë pretendimet e parashtruesve të kërkesës për të gjitha këto kategori.
21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Ligji i kontestuar me hyrjen në fuqi shfuqizon dy ligje: (i) Ligjin Nr. 04/L220 për Investimet e Huaja dhe (ii) Ligjin Nr. 05/1—079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, me ç'rast nuk i adreson fare çështjet e fushëveprimit të dispozitave ligjore mbi investitorët e jashtëm dhe investitorët përfitues të statusit të investitorit strategjik të cilët ishin përfitues të dispozitave ligjore të shfuqizuara duke krijuar pasiguri juridike për investimet e tyre si dhe nga ana tjetër nuk e rregullon çështjen e trajtimit të kërkesave të cilat veçse janë parashtruar mbi bazën e dy ligjeve të shfuqizuara duke mos iu dhënë zgjidhje juridike rasteve të tilla.
22. Në vijim, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se përmes themelimit të 2 (dy) agjencive të reja, përkatësisht: (i) Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve (AIE) dhe (ii) Agjencisë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK), nënkupton shuarjen e agjencisë ekzistuese për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, zyrtarët publik të të cilës nuk kanë asnjë siguri juridike për sa i përket statusit të tyre të marrëdhënies së punës. Po ashtu parashtruesit e kërkesës potencojnë: *“Me përjashtim të përcaktimit me ligjin kontestues që Ministria të merr përsipër sistematizimin e tyre duke iu mohuar të njëjtëve të drejtën kushtetuese për marrëdhënie të punës nga njëra anë dhe të zgjedhjes së profesionit dhe vendit të punës nga ana tjetër.”*, e që një gjë e tillë paraqet shkeljen e radhës.
23. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që ligji i kontestuar është në kundërshtim edhe me parimet e organizimit të marrëdhënieve ekonomike në Republikën e Kosovës duke e kufizuar konkurrencën e lirë dhe duke mundësuar arbitraritet të

Qeverisë respektivisht të *Këshillit të Investimeve* nga neni 21 i ligjit në raport me nenin 122 të Kushtetutës, respektivisht mos përcaktimin e kushteve të arsyeshme me ligj për shfrytëzimin e resurseve natyrore të Republikës së Kosovës nga paragrafi 2 i këtij neni.

24. Tutje, parashtruesit e kërkesës vendosin theksin tek neni 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) i ligjit të kontestuar, duke pretenduar që i njëjti cenon parimin dhe të drejtën e barazisë para ligjit nga neni 24 i Kushtetutës sepse krijon mundësi arbitraret në përzgjedhjen e investitorit strategjik përmes një procedure të negociimit të drejtpërdrejtë nga ana e Këshillit të Investimeve, procedurë kjo e cila nuk parashihet fare as me dispozitat e ligjit bazik në fuqi për prokurimin publik, ku dispozitat e këtij të fundit, përkatësisht neni 3 i tij, i kanë qartësisht të përcaktuara rrethanat dhe rastet e përjashtimit nga procedura e prokurimit, e të cilat i referohen ekskluzivisht kontratave të furnizimeve dhe të blerjeve, por nuk parashohin edhe mundësinë e zbatimit për rrethana të tjera sikurse është propozuar në nenin 35 paragrafi 2. të ligjit të kontestuar në të cilin shprehimisht përcaktohet si në vijim: *“2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli mund të përzgjedhë me negociim të drejtpërdrejtë shoqërinë e besuar për propozues, zbatues ose partner për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese në përputhje me legjislacionin në fuqi. Është shoqëri e besuar shoqëria tregtare me reputacion të mirë dhe referenca të njohura ndërkombëtare për nga veprimtaria ekonomike, etika biznesore dhe qeverisja e avancuar korporative, të dëshmuara nga institucionet financiare dhe audituese.”*
25. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ligji i kontestuar pamundëson: (i) sigurimin e mjedisit të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut; (ii) lirinë e aktivitetit ekonomik; dhe (iii) sigurinë e pronës publike dhe private; si dhe cenon (iv) të drejtën në trajtim të barabartë të të gjithë investitorëve si atyre të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm sepse e kufizon konkurrencën e lirë duke krijuar kushte për pozitë dominuese në treg përfshirë vendosjen e praktikave që e kufizojnë konkurrencën e lirë si njëri nga parimet themelore të marrëdhënieve ekonomike në Republikën e Kosovës.
26. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (I) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (II) të konstatojë se Ligji Nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nuk është në përputhshmëri me nenin 7 (Vlerat), Nenin 24 (Barazia para Ligjit), Nenin 119 (Parimet e Përgjithshme) dhe Nenin 122 (Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore) të Kushtetutës; (III) si dhe të theksojë se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Komentet dhe përgjigjet e dorëzuara nga palët e interesuara

27. Në vijim, Gjykata do të paraqesë përgjigjet në kërkesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht: (i) komentet e Zyrës së Kryeministrit në emër të Qeverisë së Kosovës; si dhe (ii) komentet e grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!
(i) Komentet e Zyrës së Kryeministrit në emër të Qeverisë së Kosovës në kërkesën e parashtruesit të kërkesës
28. Më 6 dhjetor 2023, Zyra e Kryeministrit dorëzoi në Gjykatë *“Komentet e Qeverisë lidhur me kërkesën KO173/22”* duke theksuar se pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk kanë bazë në Kushtetutë dhe se çdo dispozitë e Ligjit të ri është e menduar në interes të tërheqjes e mbrojtjes së investimeve në Republikën e Kosovës, në dritën e dispozitave Kushtetuese.
29. Zyra e Kryeministrit e konsideron të pasaktë pretendimin e parashtruesve të kërkesës që *“përmes dy ligjeve të shfuqizuara, është shkelur Kushtetuta pasi u janë mohuar të drejtat investitorëve të bazuara në ligjet e shfuqizuara”*, për dy arsye: (1) Ligji për Investimet e Qëndrueshme në Republikën e Kosovës ngërthen në vete dispozita të cilat kanë për qëllim kryesor nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve në Republikën e Kosovës, duke dhënë garanci

- shtesë karshi ligjit të shfuqizuar për Investimet Strategjike dhe atij për Investimet e Huaja; (2) të drejtat e fituara në bazë të ligjeve paraprake për investitorët strategjikë kanë rezultuar me marrëdhënie kontraktuale ndërmjet investitorit dhe shtetit të Kosovës, detyrimet dhe obligimet nga e cila marrëdhënie janë të vlefshme deri në përfundimin e kohëzgjatjes së kontratës. Për më tepër, Zyra e Kryeministrit thekson që Ligji i kontestuar është në përputhje të pjesshme me rregulloret e aplikueshme të BE-së, si dhe përcakton që: *"të gjithë investitorët dhe investimet e tyre janë të barabarta para ligjit"*.
30. Në vijim, Zyra e Kryeministrit thekson që Ligji i kontestuar përcakton që: *"investitori dhe investimet gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi"*. Rrjedhimisht, sipas tyre, mbrojtja e investimeve nuk mund të jetë më pak e favorshme se ajo e paraparë me ligj apo *"me normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare"*. Në vazhdim, Zyra e Kryeministrit thekson: *"Republika e Kosovës nxit dhe mbron investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me 1) parimet e investimit të përgjegjshëm të mbështetura nga Kombet e Bashkuara"*.
 31. Për sa i përket komenteve të pranuar të Zyrës së Kryeministrit, të njëjtit në kontekst të vlerësimit të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, theksojnë që Ligji i kontestuar siguron ndalimin e diskriminimit ndaj investitorit dhe investimit, gjë e cila aplikohet edhe në statusin e investitorit strategjik veçse të fituar në bazë të ligjeve të shfuqizuara. Rrjedhimisht, sipas Zyrës së Kryeministrit, Ligji i kontestuar është në pajtim me vlerën e ndalimit të diskriminimit.
 32. Në vijim, Zyra e Kryeministrit thekson se në ndërlidhje me parimin e ekonomisë së tregut *"ekonomia e tregut është sistem i tillë i ekonomisë që bazohet në sistemin e ndërmarrësisë dhe konkurrencës së lirë, dhe duke vepruar nëpërmjet mekanizmave të tregut, ku oferta dhe kërkesa përcaktojnë çmimet në treg. Tregu dhe mekanizmi i tregut si të tilla janë të bazuara në teorinë ekonomike. Pjesëmarrësit janë të lirë për të vepruar në kushtet e konkurrencës së lirë dhe ekonomisë së tregut, kurse ekonomia e liri e tregut përfshin fushat e mallrave, shërbimeve, prodhimeve, punës, tokës dhe kapitalit. Ekonomia e tregut nënkupton konkurrencën dhe zgjedhjen e lirë të konsumatorit, e parakushti kryesor për funksionimin e saj është ekzistimi i pronës private. Në ekonominë e tregut, përveç parimit laissez faire, shteti ka obligim për të vendosur rregullat e përgjithshme të lojës së aktiviteteve ekonomike dhe për të siguruar sundimin e ligjit."*
 33. Pra, sipas Zyrës së Kryeministrit, shteti, respektivisht Qeveria si propozuese e pastaj Kuvendi, kanë përcaktuar rregullat e përgjithshme të lojës së aktiviteteve ekonomike tek çështjet e investimeve pikërisht në bazë të Ligjit të kontestuar. Duke përcaktuara rregulla të qarta për investimet në Republikën e Kosovës, mbrojtjen e këtyre investimeve, ndalimin e diskriminimit, përparësive të fituara në bazë të Ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, duke siguruar njëkohësisht barazi ndërmjet investimit të huaj me atë vendor, shteti ka vendosur standard të lartë e rregulla të qarta të lojës apo përcaktimit të aktiviteteve ekonomike tek çështjet e investimeve.
 34. Prandaj, në dritën e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, Zyra e Kryeministrit në emër të Qeverisë konsideron që parashtruesit e kërkesës nuk kanë elaboruar se cila pikë e Ligjit të kontestuar nuk është në pajtim me nenin 7 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, hedh poshtë pretendimin për kundërshtim të Ligjit të kontestuar me vlerat e mbrojtura me Kushtetutë.
 35. Në ndërlidhje me komentet për sa i përket përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Zyra e Kryeministrit thekson që Ligji i kontestuar shprehimisht ndalon diskriminimin dhe imponon apo kërkon shprehimisht barazinë e të gjithë investimeve dhe investitorëve para ligjit. Prandaj sipas tyre, kundërshtimi i Ligjit të kontestuar nga ana e parashtruesve të kërkesës me Kushtetutën në këtë pikë nuk qëndron.

36. Sipas Zyrës së Kryeministrit “Çdo investitor (që gëzon status të tillë në Republikën e Kosovës) e çdo investim trajtohen në mënyrë të barabartë, ashtu si trajtohen të gjitha aplikacionet e dorëzuara para aktualisht Këshillit të Ministrave, e si do trajtohen edhe nga Këshilli për Investime pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri.” Rrjedhimisht, theksojnë që puna e institucioneve publike është transparente dhe qasja në të njëjtat bëhet përmes ligjit në fuqi për qasje në dokumente publike. Rrjedhimisht, çdo diskriminim apo pabarazi eventuale është lehtësisht e dëshmueshme dhe në bazë të legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës bëhet e qartë për publikun.
37. Në ndërlidhje me komentet për sa i përket përputhshmërisë së Ligjit të kontestuar me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, Zyra e Kryeministrit thekson që pikërisht Ligji i kontestuar përcakton barazinë dhe largon mundësinë e diskriminimit në trajtim.
38. Zyra e Kryeministrit thekson që “Neni 119.3 përcakton që veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj. Ky nen, sipas tyre vendos disa nga parimet e politikës së konkurrencës, që janë ndalimi i pozitës dominuese në treg të një subjekti ekonomik dhe ndalimi i abuzimeve që rrjedhin nga monopolizimi i tregut. Në kuptim të këtij neni, përjashtimet nga liria e konkurrencës dhe ndalimi i abuzimeve me pozitën dominante dhe me monopolin ekonomik duhet vendosur vetëm me ligj, të shoqëruar me kushtin që ato të jenë të cekura në mënyrë eksplicite.”
39. Konkretisht, Zyra e Kryeministrit thekson: “pozita dominuese apo monopoli paraqet abuzim në treg” dhe jo rregullat e qarta me të cilat udhëhiqet një Këshill Investiv si organ shtetëror e që vepron në bazë të parimeve të transparencës. Të njëjtit theksojnë që sipas Ligjit të kontestuar, Këshilli: “bën vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vendos për projektet për investime strategjike në përputhje me dispozitat e këtij ligji” dhe “miraton plane veprimi e raporte për mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke u kushtuar vëmendje mënjanimin të barrierave për investimet, përmirësimin të mjedisit të veprimitarisë ekonomike, mundësive zhvillimore dhe përparësive krahasuese të Republikës së Kosovës”. Rrjedhimisht, sipas Zyrës së Kryeministrit, Këshilli jo vetëm që nuk abuzon por ka për detyrë të mënjanojë barrierat për investimet e të përmirësojë mjedisin e veprimitarisë ekonomike. Prandaj, veprimi i Këshillit është në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën, përkatësisht nenin 119 duke parandaluar në tërësi mundësimin e përcaktimit të pozitës dominuese.
40. Tutje, Zyra e Kryeministrit, potencon se Këshilli për Investime bën edhe inkurajimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes promovimit të investimeve e largimit të barrierave, në harmoni me nenin 119 paragrafi 4 si më poshtë: “Neni 119.4 përcakton detyrimin e shtetit të Kosovës që të promovojë mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, duke e inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Dy janë parimet bazike që rrjedhin nga neni në fjalë: një, që shteti të ketë detyrimin për të garantuar një mjedis bazik të mirëqenies sociale për qytetarët e saj; që është një detyrim relativisht i rëndësishëm por edhe intervencionist; dhe dy, që shteti të inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes politikave të saj publike. Në kuptim të kësaj të fundit, neni 119.4 nuk e bën shtetin bartës të zhvillimit ekonomik, por i vë detyrimin që të ndërtojë kushtet bazike në mënyrë që sektori privat të mund ta çoj një zhvillim të tillë përpara.”
41. Në vijim, Zyra e Kryeministrit thekson që: neni 119 paragrafi 6 është respektuar në tërësi nga Ligji i ri, pasi që investitorëve të jashtëm, ashtu si atyre vendorë, iu mundësohet natyrisht fitimi dhe kapitali i investuar jashtë vendit, ashtu siç e parashohin dispozitat e Ligjit të kontestuar (neni 9) i cili përcakton që investitori duhet t’iu nënshtrohet parimeve të lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe kapitalit).

42. Për sa i përket nenit 122 të Kushtetutës, Zyra e Kryeministrit shpreh: *“Komentari i Kushtetutës është më se i qartë kur bëhet fjalë për nenin 122: qytetarët mund të shfrytëzojnë resurset natyrore në pajtim me ligjin; zonat e veçanta me interes publik mbrohen sipas ligjit dhe, eksploatimi e pastaj kompensimi për eksploatim të tillë rregullohet me ligj. Qeveria nuk kufizon në asnjë formë të drejtat pronësore të mbrojtura me Kushtetutë dhe nenin 22 në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës që siguron zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Rrjedhimisht, kufizimi gjithnjë bëhet në bazë të ligjit të miratuar nga Kuvendi i Republikës dhe në pajtim me standardet e lartpërmendura të cilat, sipas Kushtetutës, kanë supremaci mbi legjislacionin vendor.”*
43. Zyra e Kryeministrit gjithashtu potencon se përmes Ligjit të kontestuar *“prona e paluajtshme publike jepet në shfrytëzim për investimin strategjik pas miratimit të Kuvendit të Republikës dhe në përputhje me ligjin përkatës për shpronësimin e pronës së paluajtshme nëse prona është në pronësi shoqërore.”* Gjithashtu, Qeveria e pastaj Kuvendi do veprojnë në bazë të legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës për pronën publike rrjedhimisht: 1) investimi apo investitori nuk mund të diskriminohen; 2) toka apo prona publike ndahet në shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi; 3) prona private nuk preket në asnjë formë; 4) të gjithëve u ofrohen të drejtat e barabarta. Në pajtim me këtë, nuk bëhet e qartë se ku pretendojnë parashtruesit e kërkesës që shkelet Kushtetuta me Ligjin e kontestuar në kuptim të nenit 122 të saj.
44. Zyra e Kryeministrit lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës në kontekst *“të mohimit të të drejtave të zyrtarëve publik që shërbejnë në kuadër të KIESA-s”*, thekson që Ligji i kontestuar, përcakton që: *“sistematizimi i zyrtarëve do bëhet nga Ministria”*, gjë e cila qartazi pohon që zyrtarët nuk do mbesin pa vendet e tyre të punës. Ndërsa, lidhur me pretendimin për sa i përket që zyrtarët nuk mund të zgjedhin vendin e tyre të punës, Zyra e Kryeministrit thekson se Divizioni për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik sipas Ligjit për Zyrtarët Publik bën sistematizimin e zyrtarëve në kuadër të administratës shtetërore në bazë të rregullave të shkruara e të publikuara brenda Ligjit për Zyrtarët Publik. Rrjedhimisht, nën asnjë rrethanë, zyrtarët nuk mund të zgjedhin vendin e tyre të preferuar por sistematizohen në bazë të nevojave ku nuk është e përjashtuar mundësia e vendosjes në vendin e dëshiruar, në varësi nga vendet e lira në dispozicion dhe interesi i administratës publike të cilës i shërbejnë, i menaxhuar nga Divizioni i lartpërmendur. Duke siguruar kështu vendin e punës, pagën, si dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës, zyrtarëve nuk u mohohen të drejtat e fituara kushtetuese pasi që e drejta e tyre e fituar konsiston në të drejtën e ushtrimit të punës dhe zbatimit të kontratës, e assesi pozitës.
45. Sipas Zyrës së Kryeministrit, shfrytëzimi i resurseve natyrore, apo pronës në qëllim të zbatimit të investimit strategjik që njëkohësisht është edhe hap para zhvillimit ekonomik, varet nga fjala e ligjit, kompetencat e Qeverisë dhe të organeve tjera publike në raport me ruajtjen apo dhënien në shfrytëzim të resurseve natyrore. Kushtetuta mbron resurset me interes shtetëror duke imponuar ruajtjen e tyre me ligj por edhe lejon shfrytëzimin e të tjerave në bazë të ligjit. Zyra e Kryeministrit thekson që Ligji i kontestuar i jep kompetencë Kuvendit për dhënie të resurseve natyrore - pronës ashtu siç e përcakton Kushtetuta. Sipas tyre, legjislacioni tjetër i aplikueshëm në fuqi që rregullon shfrytëzimin e resurseve natyrore, për shembull ujit, nuk kundërshton këtë Ligj. Andaj, Zyra e Kryeministrit konkludon që argumentet e parashtruesit në raport me nenin 122 të Kushtetutës e në ndërlidhje me kompetencat e Këshillit për Investime janë të paqëndrueshme.
46. Zyra e Kryeministrit fillimisht sqaron se përderisa Qeveria është përgjegjëse për sigurim të zbatimit të investimit, duhet të jetë përgjegjëse edhe për dështimin e investimit eventual. Rrjedhimisht, Ligji i kontestuar obligon Qeverinë apo Këshillin që përjashtimisht, të ftojë shoqëri tregtare me renome që të bëjë zbatimin e investimit, sipas

kritereve vlerësuese të parapara me këtë Ligj, sipas rregullave transparente e publike duke mos i lënë asgjë në diskrecion Këshillit. Për më tepër, çështja e negociimit të drejtpërdrejtë, sipas Zyrës së Kryeministrit nuk paraqet përjashtim nga prokurimi publik. Në vijim Zyra e Kryeministrit decidivisht thekson si në vijim: *“Sipas legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, negociimi direkt paraqet një formë të prokurimit dhe si rrjedhojë, kjo formë nuk mund të jetë pjesë e nenit 3 të legjislacionit të aplikueshëm për prokurimin publik. Andaj, as një dispozitë e këtillë jo vetëm që nuk del jashtë konturave të legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, por nuk mund të jetë në mospërputhje me Kushtetutën, marrë parasysh interpretimet e dhëna më lart në raport me vlerësimin e nenit 119 dhe 122 të Kushtetutës.”*

47. Përfundimisht Zyra e Kryeministrit, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës konsideron që: (i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës jo vetëm që nuk janë të elaboruara mirë e qartë por në asnjë mënyrë nuk mund të konstatojnë shkelje të Kushtetutës nga ana e Ligjit të kontestuar; (ii) Gjykata Kushtetuese duhet të hedh poshtë të gjitha pretendimet e parashtruesit dhe të lë në fuqi Ligjin për Investimet e Qëndrueshme në Republikën e Kosovës.

(ii) Komentet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!

48. Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, përmes deputetes z. Mimoza Kusari Lila, dorëzoi në Gjykatë komentet duke theksuar fillimisht se: *“Pretendimi se ligji i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën në tërësi, vetëm se me hyrjen e tij në fuqi shfuqizon dy ligje tjera, nuk është serioze dhe nuk përbën kurrfarë çështje kushtetuese apo argument kushtetues. Ky qëndrim i paraqitur nga parashtruesit e ankesës që orientohet më shumë për formën e rregullimit të një çështje sesa për përmbajtjen e rregullimit është padyshim jashtë sferës së rregullimeve kushtetues dhe më shumë i referohet le të themi teknikës legjislative si disiplinë shkollore.”*
49. Sipas komenteve të tyre, mënyra se si janë formuluar pretendimet e parashtruesve përpiqet të konstatojë se Kushtetuta e detyron sponzorizuesin dhe/ose ligjvënësin të propozojnë dhe miratojnë vetën ligje të caktuara apo të mos ndryshojnë ato ekzistueset. Rrjedhimisht, sipas tyre, ky pretendim i parashtruesve të kërkesës nuk paraqet çështje kushtetuese.
50. Në vijim, komentet theksojnë që *“kërkesa e paraqitur para Gjykatës Kushtetuese nga parashtruesi nuk ka asnjë referencë konkrete se cila dispozitë të ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën.”* Pra sipas komenteve rezulton që: *“Kushtetuta pra e ka të përkufizuar shumë qartë se Qeveria dhe Kuvendi kanë të drejtën e tyre të plotë të propozojnë dhe miratojnë reforma në formën e ligjeve dhe akteve të tjera të parashikuara me vet Kushtetutën dhe akte të tjera ligjore.”*
51. Tutje, komentet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, theksojnë që përmbajtja e reformave është çështje e vullnetit politik, qasjes programore dhe propozimeve profesionale që një mazhorancë e caktuar realizon teksa përmbush mandatin e saj kushtetues që buron nga zgjedhjet e ligjshme dhe legjitime nga ku burojnë edhe Kuvendi dhe Qeveria.
52. Në vazhdim komentet theksojnë që parashtruesit e kërkesës përmes pretendimeve të tyre ngrisin çështje të kolizionit në mes të ligjeve, prandaj e njëjta nuk paraqet çështje kushtetuese dhe se Gjykata Kushtetuese nuk ka autorizime të vlerësojë apo të konstatojë kolizionin potencial në mes të ligjeve.
53. Në vijim, komentet theksojnë që edhe pretendimi i parashtruesve të kërkesës se me Ligjin e kontestuar themelohen dy agjenci të reja, duke shuar një Agjenci ekzistuese, nuk ofrojnë

asnjë argument të vetëm se si dhe ku kjo çështje paraqet çështje kushtetuese në radhë të parë dhe se si kjo na qenka në kundërshtim me Kushtetutën.

54. Në këtë narrativë, komentet në vijim theksojnë që përcaktimi që të punësuarit e Agjencisë që potencialisht shuhet apo transformohet sistematizohen në vende të punës nga Ministria përkatëse, është plotësisht në funksion të menaxhimit të çfarëdo efekti që mund të shkaktojë procesi i transformimit të një rregullimi nga përcaktimet ligjore të reja gjatë zbatimit të ligjit.
55. Sipas komenteve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, argumentet e parashtruesve të kërkesës përveçse të pasaktë, janë edhe irracionale, sepse asnjë institucion apo agjenci nuk themelohet dhe nuk ekziston për të punësuarit e tij, por të punësuarit e tyre janë në funksion të realizimit të mandatit ligjor të institucionit. Në vijim, të njëjtit theksojnë që (i) Ligji nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura dhe (ii) Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik që e rregullojnë çështjen e shuarjes dhe themelimit të agjencive ekzekutive dhe atë të sistematizimit të shërbyesve civil, zyrtarëve publik dhe çdo të punësuarit në institucionet publike në çdo rrethanë të krijuar dhe normuar me ligjet e veçanta për këto institucione.
56. Përmes komenteve të tyre, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! theksojnë që Ligji i Kontestuar është në përputhje të plotë me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës dhe se i njëjti nuk bie ndesh me nenet 7 [Vlerat], Nenin 24 [Barazia para Ligjit], Nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe Nenin 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] si dhe pjesërisht është në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 mars 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në BE.
57. Në vijim, komentet theksojnë se Ligji i kontestuar përcakton që të gjithë investitorët dhe investimet e tyre janë të barabartë para ligjit. Poashtu, bazuar në nenin 7 të Ligjit të kontestuar-Mbrojtja dhe siguria - Investitori dhe investimet gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra, me ligjin e kontestuar janë garantuar të drejtat e investitorëve pa dallim nga statusi i tyre.
58. Gjithashtu, sipas komenteve ligji nuk ka efekt retroaktiv, pra të gjitha kërkesat të cilat veçse janë parashtruar mbi bazën e dy ligjeve të shfuqizuar do të trajtohen në bazë të këtyre dy ligjeve. Rrjedhimisht asnjë e drejtë e fituar nuk cenohet apo kufizohet, përkundrazi Ligji i Kontestuar e avancoi infrastrukturën ligjore dhe institucionale në favor të investitorëve.
59. Përfundimisht, Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kërkon nga Gjykata që pretendimet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës t'i hedhë poshtë si të pabazuara dhe ta shpallë Ligjin e kontestuar si në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën.

Dispozitat dhe dokumentet relevante

60. Në vijim, Gjykata do të paraqesë: (I) dispozitat relevante të Kushtetutës; (II) dispozitat relevante të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, përfshirë: (i) Ligjin Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërin anë, dhe BE-së dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër; (ii) Ligjin e kontestuar; (iii) Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës; dhe (iv) Ligjin nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

DISPOZITAT RELEVANTE TË KUSHTETUTËS

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 **[Vlerat]**

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”

Neni 10 **[Ekonomia]**

“Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.”

Kapitulli II **Të Drejtat dhe Liritë Themelore**

Neni 21 **[Parimet e Përgjithshme]**

- 1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.*
- 2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*
- 3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*
- 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*
[...]

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve]

- 1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.*
- 3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.*
- 4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.*
- 5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.*
- 6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.*

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
 - (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
 - (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- [...]

Kapitulli IX Marrëdhëniet Ekonomike

Neni 119

[Parimet e Përgjithshme]

- “1. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.
2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.
3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.
4. Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
5. Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.
6. Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.
7. Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.
8. Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.
9. Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.
10. Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.”

Neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

1. Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.
2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.
3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.

Neni 142 [Agjencitë e Pavarura]

1. Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.

2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.
3. Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.

I. DISPOZITAT RELEVANTE TË LIGJEVE TË APLIKUESHME

LIGJI Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër

Neni 98 Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve përqendrohet në mbrojtjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja dhe synon krijimin e një klime të favorshme për investimet private vendase dhe të huaja që është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Kosovës. Qëllimet e veçanta të bashkëpunimit do të jenë që Kosova të përmirësoj kornizën ligjore për të favorizuar dhe mbrojtur investimet.

II. Ligji i kontestuar: **LIGJ Nr.08 /L-209 PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME**

KAPITULLI 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim promovimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve të qëndrueshme dhe eksporteve në Republikën e Kosovës, përfshirë përcaktimin e sektorëve prioritar për zhvillim.
2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 marsit 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky ligj përcakton të drejtat dhe detyrimet e institucioneve, autoriteteve publike dhe investitorëve lidhur me investimet në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen:
 - 1.1. **Investim** - kapitali që përdoret për të zhvilluar veprimtarinë ekonomike në Republikën e Kosovës, me qëllim të krijimit të të ardhurave dhe fitimit. Investim mund të jetë:
 - 1.1.1. valuta;
 - 1.1.2. e drejta mbi sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm, siç është pronësia, qiraja ose e drejta e ngjashme;
 - 1.1.3. aksioni ose forma tjetër e pjesëmarrjes në shoqëri tregtare;

- 1.1.4. e drejta e pronësisë intelektuale ose industriale, siç është e drejta e autorit, patenta, marka tregtare, dizajni industrial, e drejta e mbarështuesit, ecuria teknike, njohuria praktike, fshehtësia tregtare, treguesi gjeografik, emri tregtar lidhur me investimin;
- 1.1.5. instrumenti financiar;
- 1.1.6. leja, licenca ose e drejta tjetër komerciale e përcaktuar me ligj, kontratë ose akt tjetër.
- 1.2. **Investitor:**
- 1.2.1. Person fizik me shtetësi të Republikës së Kosovës ose shtetësi të huaj, që ka për qëllim investimin në Republikën e Kosovës sipas këtij ligji;
- 1.2.2. Person juridik ose çdo subjekt i krijuar në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi ose ligjeve të huaja që ka për qëllim investimin në Republikën e Kosovës sipas këtij ligji;
- 1.3. **Investitor i huaj** - është investitor si vijon:
- 1.3.1. Personi i cili nuk ka shtetësi të Republikës së Kosovës;
- 1.3.2. Shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjeve të shtetit të huaj;
- 1.3.3. Shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës në të cilën personi nga nënparagrafet 1.3.1-1.3.3 të këtij neni zotëron shumicën e vendimmarrjes.
- 1.4. **Investim strategjik** - një investim në sektorët prioritar dhe/apo objektivat të përcaktuara në këtë ligj.
- 1.5. **Investim i qëndrueshëm** - një investim afatgjatë në Republikën e Kosovës në një aktivitet ekonomik që kontribuon në përmbushjen një apo më shumë objektivave dhe sektorëve prioritar të përcaktuar me këtë ligj.
- 1.6. **Eksportues** - shoqëri tregtare të identifikuar si eksportues sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, Doganës së Kosovës dhe të regjistruar në regjistrin shtetëror të administruar nga AIE.
- 1.7. **Institucion publik** - Organi qendror ose lokal me kompetencë ligjvënëse, ekzekutive, administrative dhe rregullatorë në Republikën e Kosovës;
- 1.8. **Valutë lehtësisht e konvertueshme** - valuta lehtësisht e konvertueshme e njohur nga Banka Qendrore e Kosovës, Banka Qendrore Evropiane ose Fondi Monetar Ndërkombëtar;
- 1.9. **Kontest i investimit** - mosmarrëveshja ose pretendimi lidhur me investimin, që i paraqitet për zgjidhjes përmes ndërmjetësimit, apo Gjykatës Komerciale vendore ose Tribunalit të Arbitrazhit;
- 1.10. **Këshilli** - Këshilli i Investimeve i Republikës së Kosovës;
- 1.11. **Ministria** - ministria përkatëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;
- 1.12. **Ministri** - ministri përkatëse për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë;
- 1.13. **Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AID)** - Agjencia për promovimin dhe rritjen e investimeve dhe eksporteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;
- 1.14. **Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK)** - Agjencia për përkrahjen e zhvillimit të NVM-ve, start-up-ëve dhe ekosistemeve përkatëse, turizmit dhe zhvillimit e monitorimit e parqeve industriale e teknologjike, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- 1.15. **Paneli Ankimor** - Paneli Ankimor i Investimeve i Republikës së Kosovës;

Neni 4 Parimet themelore

1. Republika e Kosovës nxit dhe mbrohet investimet e përgjegjshme dhe të qëndrueshme, në përputhje me këto instrumente:
- 1.1. Parimet e investimit të përgjegjshëm të mbështetura nga Kombet e Bashkuara;
- 1.2. Deklarata dhe vendimet për investimet ndërkombëtare dhe ndërmarrjet shumëkombëshe të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

KAPITULLI II TË DREJTAT DHE DETYRIMET E INVESTITORIT

Neni 5 E drejta e investimit

Personi ka të drejtë të investojë në çdo lloj të veprimtarisë ekonomike dhe në çdo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6 Barazia para ligjit

1. *Të gjithë investitorët dhe investimet e tyre janë të barabartë para ligjit.*
2. *Investitori i huaj ka të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore sikurse investitori vendor.*
3. *Investitori i nënshtrohet detyrimit të pajtueshmërisë me ligjin sipas nenit 9 të këtij ligji.*
4. *Investitori mund të gëzojë përfitim ose përparësi të posaçme sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, sidomos lidhur me:*
 - 4.1. *Mënyrën e zgjidhjes së kontestit të investimeve;*
 - 4.2. *Bashkimin doganor, ekonomik ose monetar, tregun e përbashkët, hapësirën e tregtisë së lirë ose organizatat ekonomike rajonale dhe ndërkombëtare;*
 - 4.3 *Shmangien e tatimit të dyfishtë ose çështje tjetër të tatimit.*

Neni 7 Mbrojtja dhe siguria

1. *Investitori dhe investimet gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
2. *Mbrojtja dhe siguria e investitorëve dhe investimeve nuk mund të jenë më pak të favorshme se ç' kërkohet me këtë ligj ose me normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare.*

Neni 8 Respektimi i të drejtave

1. *Institucionet publike duhet:*
 - 1.1. *të veprojnë brenda autorizimeve të veta ligjore ndaj investitorit;*
 - 1.2. *të njohin dhe të respektojnë të drejtat e investitorit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;*
 - 1.3. *të zhvillojnë procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke vepruar sidomos në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me parimet e tjera procedurale;*
 - 1.4. *t'i japë investitorit mundësi të arsyeshme për të paraqitur fakte dhe argumente në procedurën administrative, për sa lejojnë natyra e procedurës dhe interesi publik;*
 - 1.5. *të mundësojë ushtrimin e mjeteve juridike sipas Kushtetutës dhe ligjit.*
 - 1.6. *E drejta nga ky ligj mund të kufizohet në rast se cenohet rendi publik, morali, siguria shtetërore, shëndeti publik, mjedisi dhe legjislacioni në fuqi.*

Neni 9 Pajtueshmëria me ligjin

1. *Investitori i nënshtrohet legjislacionit vendor dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës.*
2. *Investitori duhet të respektojë sidomos:*

- 2.1. legjislacionin për punën, shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;
- 2.2. parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit;
- 2.3. parimet e trajtimit të barabartë dhe rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndihmës shtetërore;
- 2.4. detyrimet përkatëse për sigurimin nga përgjegjësia;
- 2.5. detyrimin për regjistrimin e pronarëve përfitues dhe legjislacionin kundër shpëlarjes së parasë, investimeve ofshore dhe financimit të terrorizmit;
- 2.6. legjislacionin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare;
- 2.7. detyrimet e Republikës së Kosovës nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian;
3. Investitori ose investimi mund t'i nënshtrohet verifikimit plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji.
4. Institucioni publik mund t'i kërkojë investitorit kompensim për dëmin e shkaktuar nga shkelja e këtij ligji ose aktit tjetër. Kompensimi caktohet sipas nenit 13 të këtij ligji.
5. Institucioni kompetent mund t'i shqiptojë investitorit sanksion për shkelje të ligjit ose aktit tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Mbrojtja nga shpronësimi

1. Investimi nuk mund të shpronësohet drejtpërdrejt apo tërthorazi.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1, i këtij neni, investimi mund të shpronësohet vetëm në rastet kur është e domosdoshme për qëllimin ose interesin publik, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për shpronësim.

KAPITULLI III

PRIORITETET DHE LEHTESIRAT

Neni 14

Objektivat shtetërore

1. Objektiva shtetërore që Republika e Kosovës synon t'i përmbushë përmes nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve janë:
 - 1.1. rritja e prodhimit dhe eksportit;
 - 1.2. nxitja e ekonomisë qarkore;
 - 1.3. rritja e konkurrueshmërisë së industrisë vendore;
 - 1.4. zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë;
 - 1.5. fuqizimi i ekosistemit industrial;
 - 1.6. aftësimi dhe punësimi i fuqisë punëtore;
 - 1.7. fuqizimi i rinisë, gruas, komuniteteve jo shumice dhe grupeve të marginalizuara;
 - 1.8. qëndrueshmëria e lëvizjes së popullsisë;
 - 1.9. angazhimi i diasporës;
 - 1.10. zhvillimi rajonal;
 - 1.11. qëndrueshmëria mjedisore.

Neni 15

Sektorët prioritarë

1. Sektorë prioritarë për investime në Republikën e Kosovës janë:
 - 1.1. industria prodhuese dhe përpunuese;
 - 1.2. bujqësia;
 - 1.3. teknologjia e informacionit dhe komunikimit;

- 1.4. arsimi dhe aftësimi, hulumtimi dhe inovacioni;
- 1.5. shëndetësia;
- 1.6. turizmi;
- 1.7. administrimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave;
- 1.8. transporti;
- 1.9. energjia;
- 1.10. minierat.

[...]

Neni 18 **Themelimi i agjencie**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK) e themeluar me Ligjin për Investime të Huaja shuhet dhe në vend të saj themelohen këto Agjenci:
 - 1.1. Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AIE);
 - 1.2. Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK).

Neni 21 **Këshilli**

1. Këshilli i Investimeve në Republikën e Kosovës bën vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vendos për projektet për investime strategjike në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji.
2. Këshilli përbehet nga:
 - 2.1. Kryeministri, kryesues;
 - 2.2. Ministri përgjegjës për industrinë, ndërmarrësinë dhe tregtinë, zëvendës kryesues;
 - 2.3. Ministri përgjegjës për financat;
 - 2.4. Ministri përgjegjës për mjedisin, planifikimin hapësinor dhe infrastrukturën;
 - 2.5. Ministri përgjegjës për ekonomi;
 - 2.6. Ministri përgjegjës për bujqësi;
 - 2.7. Ministri përgjegjës për qeverisje lokale;
3. Qeveria me vendim mund të shtojë numrin e anëtarëve të Këshillit sipas nevojës.
4. Këshilli ushtron këto përgjegjësi:
 - 4.1. miraton plane veprimi dhe raporte për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke u kushtuar vëmendje mënjanimi të barrierave për investimet, përmirësimi të mjedisit të veprimtarisë ekonomike, mundësive zhvillimore dhe përparësive krahasuese të Republikës së Kosovës;
 - 4.2. nxjerr vendime për investimet strategjike sipas nenit 36 të këtij ligji;
 - 4.3. publikon ftesa dhe negocion marrëveshje lidhur me investimet strategjike sipas neneve 29 dhe 35 të këtij ligji;
 - 4.4. përcakton masat, procedurat, afatet dhe detyrimet e autoriteteve publike lidhur me hartimin dhe zbatimin e projekteve të investimit strategjik;
 - 4.5. mbikëqyr zbatimin e investimeve strategjike;
 - 4.6. kërkon verifikim plotësues të investimeve dhe nxjerr vendime mbi vlerësimin plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji.
 - 4.7. Kryen funksione të tjera lidhur me fushën e investimeve dhe eksporteve të përcaktuara me vendim të Qeverisë.

5. Anëtari i Këshillit nuk mund të përfshihet në veprimtarinë e investimit strategjik që ka shqyrtuar pa kaluar pese (5) vjet nga përfundimi i mandatit të anëtarit.
6. AIE kryen rolin e sekretariatit për Këshillin.
7. AIE përgatitë propozimet për planet e veprimit, raportet dhe vendimet e Këshillit për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve.
8. Puna e Këshillit rregullohet me akt nënligjor të Qeverisë.

KAPITULLIV INVESTIMET STRATEGJIKE

Neni 24 Kushtet e përgjithshme

1. Investimi strategjik gëzon përparësi dhe përkrahje të posaçme sipas këtij ligji.
2. Mund të shpallet investim strategjik projekti investues që përmbush këto kushte:
 - 2.1. projekti ndihmon në përmbushjen e objektivave shtetërore nga neni 14 i këtij ligji;
 - 2.2. projekti përkon në sektorët prioritar nga neni 15 i këtij ligji;
 - 2.3. propozuesi ka dëshmuar aftësinë financiare për ta zbatuar investimin;
 - 2.4. projekti është në pajtim me nenin 30 të këtij ligji;
 - 2.5. projekti i është nënshtruar verifikimit plotësues nëse kërkohet sipas kapitullit VII të këtij ligji dhe është dhënë vendim për autorizimin e investimit sipas nenit 40 të këtij ligji.
3. Investimi strategjik duhet të arrije vlerën së paku dhjetë (10) milionë euro.
4. I jepet përparësi në përzgjedhje projektit që ka vlere më të madhe dhe ndihmon më shumë në përmbushjen e objektivave shtetërore nga neni 14 i këtij ligji, sidomos objektivat e punësimit, rritjes së prodhimit dhe eksportit, zhvillimit rajonal dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Neni 30 Propozimi i investimit strategjik

1. Propozimi i investimit strategjik i parashtrohet për shqyrtim AIE.
2. Në formularin e propozimit të investimit strategjik, propozuesi saktëson nëse kërkon shqyrtim paraprak apo shqyrtim përfundimtar.
3. Për shqyrtim paraprak, propozimi i investimit strategjik përmban këto të dhëna dhe dokumente:
 - 3.1. Formulari me të dhënat e përgjithshme për propozuesin dhe projektin investues strategjik;
 - 3.2. përshkrimi i hollësishëm i projektit, ku përfshihen:
 - 3.2.1. titulli i projektit;
 - 3.2.2. vlera e kapitalit që propozohet të investohet brenda tre (3) viteve;
 - 3.2.3. vendi ku propozohet investimi;
 - 3.2.4. përshkrimi i pronës ose objektit ku propozohet investimi;
 - 3.2.5. përshkrimi i mënyrës dhe burimit të financimit të investimit;
 - 3.2.6. plani dinamik i punimeve për kohëzgjatjen e zbatimit të projektit;
 - 3.3. përshkrimi i hollësishëm i propozuesit, përkatësisht personit fizik, personit juridik, personit përgjegjës, subjektit ëmë, filialeve, entiteteve të ndërmarrjes së përbashkët dhe partnereve, ku përfshihen:
 - 3.3.1. forma juridikë e organizimit;
 - 3.3.2. pronësia dhe pronaret përfitues;
 - 3.3.3. profili i hollësishëm;
 - 3.3.4. objektivat;

- 3.3.5. vlerat dhe etika;
- 3.3.6. Lejet dhe licencat;
- 3.3.7. e kaluara penale;
- 3.3.8. kontestet gjyqësore dhe kërkesat e pa përmbushura;
- 3.3.9. deklarata kundër konfliktit të interesit në projektin e propozuar;
- 3.3.10. njoftimi për futjen në listë të zezë nga institucionet financiare dhe subjektet e tjera;
- 3.3.11. deklarata e pajtueshmërinë me normat kundër shpëlarjes së parasë, investimeve of shore dhe financimit të terrorizmit, sipas legjislationit në fuqi dhe udhëzimeve ndërkombëtare;
- 3.4. plani i biznesit të investimit, ku përfshihen:
 - 3.4.1. përshkrimi i produktit;
 - 3.4.2. plani operativ;
 - 3.4.3. plani i menaxhimit të burimeve njerëzore;
 - 3.4.4. plani për çështjet juridike dhe sigurimin nga përgjegjësia;
 - 3.4.5. plani i shitjes dhe marketingut;
 - 3.4.6. plani i menaxhimit mjedisor dhe shoqëror;
 - 3.4.7. përshkrimi i përgjegjësive shoqërore dhe mjedisore;
 - 3.4.8. plani i menaxhimit financiar;
- 3.5. autorizimi dhënë AIE-se për të verifikuar të dhënat dhe dokumentet e parashtruara;
- 4. Për shqyrtim përfundimtar, propozimi i investimit strategjik përmban këto të dhëna dhe dokumente:
 - 4.1. të dhënat dhe dokumentet nga paragrafi 3 i këtij neni, nëse nuk janë dorëzuar me parë;
 - 4.2. referenca të përvojës në projekte të ngjashme;
 - 4.3. raportet e auditimit të propozuesit, duke përfshirë pasqyrat financiare, për tri (3) vitet e fundit;
 - 4.4. dëshmi financiare për të zbatuar projektin,
 - 4.5. dëshmi për garanci bankare;
 - 4.6. dëshmitë për pajtueshmëri me ligjin sipas nenit 9 të këtij ligji;
 - 4.7. të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për verifikim plotësues nëse kërkohet sipas kapitullit V të këtij ligji;

Neni 33 **Afatet e shqyrtimit**

1. AIE i kërkon mendim institucionit mbështetës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi i plotë i propozimit. Institucioni mbështetës jep mendimin brenda tridhjetë (30) ditëve.
2. AIE shqyrton propozimin e investimit strategjik brenda afatit si vijon:
 - 2.1. gjashtëdhjetë (60) dite nga dorëzimi i plote i propozimit për shqyrtim paraprak;
 - 2.2. nëntëdhjetë (90) ditë nga dorëzimi i plotë i propozimit për shqyrtim përfundimtar;
 - 2.3. gjashtëdhjetë (60) dite nga dorëzimi i plotë i të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara për shqyrtim përfundimtar, nëse shqyrtimi paraprak është kryer.
3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të përcaktohet afat më i shkurtër për shqyrtimin e propozimit për zbatimin e projektit të përgatitur nga palët sipas nenit 29 të këtij ligji.
4. Nëse Këshilli miraton rekomandimin paraprak të AIE për shpalljen e investimit strategjik ose refuzon rekomandimin paraprak të AIE për refuzimin e investimit

strategjik, AIE mund ti kërkoj propozuesit të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për shqyrtimin përfundimtar. Propozuesi dorëzon të dhënat dhe dokumentet e kërkuara brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve.

5. Nëse Këshilli pezullon vendimmarrjen dhe detyron AIE të kryejë shqyrtim shtesë, AIE kryen shqyrtimin shtesë brenda tridhjetë (30) ditëve.
6. Nëse kërkohet verifikim plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji, propozuesi mund t'i kërkojë AIE të kryejë verifikimin plotësues para ose krahas shqyrtimit përfundimtar të propozimit të investimit strategjik. Nëse verifikim plotësues kryhet para shqyrtimit përfundimtar, afati nga paragrafi 5 i këtij neni fillon të rrjedhë pas vendimit për autorizimin e investimit sipas nenit 40 të këtij ligji.
7. Pas verifikimit të propozimit AIE shqyrton propozimin e investimit strategjik brenda afatit si vijon:
 - 7.1. tridhjetë (30) ditë nga dorëzimi i plotë i propozimit për shqyrtim paraprak;
 - 7.2. gjashtëdhjetë (60) ditë nga dorëzimi i plotë i propozimit për shqyrtim përfundimtar;
 - 7.3. tridhjetë (30) ditë nga dorëzimi i plotë i të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara për shqyrtim përfundimtar, nëse shqyrtimi paraprak është kryer.

Neni 35

Përzgjedhja e veçantë e investitorit

1. Këshilli mund të publikojë ftesë për të përzgjedhur partnerin për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese në përputhje me legjis1acionin në fuqi.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli mund të përzgjedhë me negocim të drejtpërdrejtë shoqërinë e besuar për propozues, zbatues ose partner për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese në përputhje me legjis1acionin në fuqi. Është shoqëri e besuar shoqëria tregtare me reputacion të mirë dhe referenca të njohura ndërkombëtare për nga veprimtaria ekonomike, etika biznese dhe qeverisja e avancuar korporative, të dëshmuara nga institucionet financiare dhe audituese.
3. Këshilli mund të lidhë marrëveshje paraprake me propozuesin, zbatuesin ose partnerin nga ky nen. Marrëveshja mund të zëvendësojë propozimin nga neni 33 i këtij ligji, por duhet të jetë në përputhje me kushtet e përgjithshme nga neni 24 i këtij ligji.

Neni 40

Përcaktimi i Verifikimit plotësues

1. Mund t'i nënshtrohet verifikimit plotësues investimi i synuar ose i kryer nga personi i huaj që ka gjasa të prekë rendin publik ose sigurinë shtetërore.
2. Verifikim plotësues domethënë procedura për vlerësimin, hetimin, autorizimin, kushtëzimin, ndalimin ose largimin e investimit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Verifikimi plotësues i kushton vëmendje të veçantë pajtueshmërisë me:
 - 3.1. normat kundër shpërlarjes së parasë, investimeve of shore dhe financimit të terrorizmit, sipas legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve ndërkombëtare;
 - 3.2. legjislacionin përkatës për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.
 - 3.3. në rast të tregtisë së padrejte, Republika e Kosovës ka të drejtë të mbrojë resurset e veta shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës për tregti me jashtë.
4. Gjatë verifikimit plotësues dhe vendimmarrjes, fshehtësia tregtare mbrohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Qeveria me akt nënligjor përcakton rrethanat dhe shkaqet, të dhënat dhe dokumentet e kërkuara, si dhe mënyrën e verifikimit plotësues në përputhje me këtë kapitull.

Neni 52

Dispozita kalimtare

1. Rregullimi dhe organizimi i AIE dhe AIPNK do të rregullohen me akte të veçanta nënligjore.
2. Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, i ushtron te gjitha kompetencat në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, deri në hyrje në fuqi të akteve nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Me strukturimin e Agjencisë sipas këtij neni:
 - 3.1 Ministria merr përsipër sistematizimin e shërbyesve civil.
 - 3.2 AIE dhe AIPNK marrin secila përsipër përgjegjësitë, pronat nën administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të treta dhe procedurat administrative në vazhdim, lidhur me fushëveprimet e tyre.

Neni 53 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 34 Procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës

1. Në raste të veçanta, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pas publikimit të një njoftimi të kontratës për të kryer aktivitetin e prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit, në bazë të faktorëve të verifikueshëm dhe pa qëllime diskriminuese, duhet që paraprakisht të bëjë konstatim formal me shkrim se:
 - 1.1. për arsye të natyrës së disa shërbimeve të sigurimeve, bankare dhe të investimeve, të menaxhmentit, të konsulencës apo shërbimeve tjera intelektuale është e pamundur të përgatiten specifikacionet e kontratës në mënyrë që të lejojnë dhënien e kontratës duke zgjedhur tenderin më të mirë sipas rregullave që drejtojnë procedurat e hapura ose të kufizuara.
 - 1.2. natyra e shërbimeve ose rreziqet që përcjellin ato nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimit të përgjithshëm.
 - 1.3. natyra e shërbimeve financiare, e shërbimeve që përfshinë projektimin e punëve ose e shërbimeve tjera intelektuale është e atillë sa nuk mund të përgatiten specifikacionet e kontratës në përpikëri në mënyrë që të lejojnë dhënien e kontratës duke zgjedhur tenderin më të mirë sipas rregullave që drejtojnë procedurat e hapura ose të kufizuara.
2. Konstatimi me shkrim i kërkuar sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të përfshihet në dosjen e tenderit.
3. Pas pranimit të kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues do të ftojë me shkrim që të parashtrojnë tenderin/propozimin kandidatët të cilët përmbushin kriteret minimale të përzgjedhjes të caktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit në përputhshmëri me nenin 49-54 të këtij ligji Kandidatët që nuk përzgjidhen në këtë mënyrë eliminohen nga pjesëmarrja e mëtutjeshme.
4. Autoriteti kontraktues pastaj do të negociojë me çdo tenderues në përpjekje për të përshtatur tenderin/propozimin e tij me kërkesat e caktuara nga autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Gjatë këtij procesi, autoritetit kontraktues do t'i kërkohet të identifikojë dhe t'i jap kontratën tenderuesit që dorëzon tenderin/propozimin më të mirë dhe që është ekonomikisht më i përshtatshmi.
5. Gjatë negociatave, autoriteti kontraktues do të sigurojë se të gjithë tenderuesit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë dhe se të gjithë tenderuesit kanë qasje të barabartë

dhe me kohë në informatat e njëjta, me përjashtim të informatave që lidhen me ose që janë pjesë e ndonjë tenderi konkurrues.

6. Me kusht që mundësia është përcaktuar në njoftimin për kontratë ose në dosjen e tenderit, autoriteti kontraktues mund të merr masa që procedurat e negociuara të përdoren në faza të njëpasnjëshme me qëllim që të reduktohet me kohë numri i tenderëve të negociuar duke aplikuar kriteret e dhënies që janë specifikuar në njoftimin e kontratës ose dosjen e tenderit.

Neni 35

Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi që të jetë në pajtim me këtë nen. KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë brenda dy ditëve nga data kur vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikimin për përdorimin e procedurës.
2. Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e:

2.1. çfarëdo kontrate publike:

(i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet ti ipet një operatori të caktuar ekonomik;

(ii) nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i ipet vetëm një operatori të caktuar ekonomik;

(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

2.2. një kontrate për furnizim:

(i) për dërgesa shtesë nga furnizuesit fillestar kur dërgesat e tilla shtesë janë zëvendësime për produktet ose instalimet e dërguara ose kur përbëjnë një zgjatje të dërgesave aktuale të produkteve ose instalimeve nëse ndryshimi i furnizuesit domosdo kërkon nga autoriteti kontraktues që të pranojë produktet ose instalimet që kanë karakteristika të ndryshme teknike ose karakteristika të tjera që janë materialisht të ndryshme nga produktet ose instalimet që janë blerë më parë, dhe këto ndryshime do të rezultojnë në mospërputhshmëri apo vështirësi teknike të jashtëzakonshme në funksionim dhe mirëmbajtje. Me kusht që, sidoqoftë, ky nen 35.2.2(i) të mund të përdoret vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për dërgesa shtesë që vetëm, ose së bashku, e kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës që mbulonte dërgesat fillestare; ose

(ii) Nëse autoriteti përkatës kontraktues është operator i shërbimeve publike, për blerjen e mallrave në një treg mallrash, vend-shkëmbim mallrash apo platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.

2.3. një kontratë të shërbimeve:

(i) që pason nga një konkurs projektimi i ushtruar përmes procedurave të hapura ose të kufizuara, dhe që kërkohet, sipas rregullave në fuqi, t'i epet kandidatit të suksesshëm.

(ii) që do ti epet një autoriteti kontraktues që sipas një akti legjislativ ose rregullativ normativ ose nën-normativ e gëzon një të drejtë ekskluzive për të siguruar shërbimin e tillë.

2.4. një kontrate të shërbimeve ose punëve:

(i) për zbatimin ose ekzekutimin e shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë, por të cilat, përmes rrethanave të paparashikuara, janë bërë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve ose punëve të përshkruara në projektin ose kontratën e tillë. Me kusht që ky nen 35.2.4 (i) të mund të shfrytëzohet vetëm nëse (a) kontrata që i mbulon shërbimet ose punët e tilla shtesë ti ipet operatorit ekonomik që është duke i ekzekutuar shërbimet ose punët fillestare dhe (b) shërbimet ose punët e tilla shtesë, teknikisht ose ekonomikisht nuk mund të ndahen nga kontrata kryesore pa i shkaktuar dëme autoritetit kontraktues apo (c) kur punët apo shërbimet e tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë rreptësisht të domosdoshme për atë kompletim. Më tutje, me kusht që, ky nen 35.2.4(i) të mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime ose punë shtesë që vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës fillestare.

(ii) për punë apo shërbime të reja që bëjnë pjesë në përsëritjen e punëve apo shërbimeve të ngjashme dhe që iu besuan operatorit ekonomik të cilit i njëjti autoritet kontraktues i dha kontratën fillestare, me kusht që punët e tilla të janë në përputhje me një projekt bazik për të cilin kontrata origjinale ishte dhënë sipas procedurës së hapur ose të kufizuar. Sa më herët që projekti i parë të është paraqitur për tender, përdorimi i mundshëm i kësaj procedure do të deklarohet dhe kosotja totale e parashikuar e punimeve apo shërbimeve pasuese duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese, kur ata të aplikojnë rregullat e vlerësimit të Kapitullit 4. Autoritetet publike mund të përdorin këtë procedurë vetëm gjatë një periudhe prej dy viteve pas përfundimit të kontratës fillestare. Me kusht që, sidoqoftë, neni 2.4 (ii) mund të shfrytëzohet vetëm për të mbuluar një ose më shumë kontrata për shërbime të reja që, vetëm ose së bashku kanë një vlerë që nuk është më e madhe se dhjetë përqind (10%) e vlerës së kontratës të mëhershme të shërbimeve.

3. Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rrol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.

LIGJI NR. 06/L-113 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE TË AGJENCIVE TË PAVARURA

KAPITULLI IV

KRIJIMI, BASHKIMI DHE SHUARJA E AGJENCIVE

Neni 48 Krijimi i një agjencie të re

1. Ligji që themelon një agjenci ekzekutive apo rregullatore (ne vijim: Agjenci) duhet të përfshijë të paktën këto dispozita:
- 1.1. emrin;
 - 1.2. statusin e agjencisë (nëse është agjenci ekzekutive, rregullatore apo e pavarur);
 - 1.3. funksionet dhe kompetencat e agjencisë;

- 1.4. dispozitat për organin drejtues të agjencisë dhe mbikëqyrjen e performancës të veprimtarisë së saj, nëse janë të ndryshme nga dispozitat e përcaktuara me këtë ligj;
- 1.5. afatin për emërimin e organit drejtues të agjencisë.
2. Ligji që themelon një agjenci përcakton edhe:
 - 2.1. ministrinë përgjegjëse, nën varësinë dhe/apo mbikëqyrjen e së cilës themelohet dhe funksionon agjencia apo të përcaktojë se agjencia ekzekutive funksionon nën përgjegjësinë e Kryeministrit, dhe degët lokale si dhe funksionet administrative dhe kompetencat e tyre.
3. Memorandumi shpjegues, që shoqëron projektligjin për themelimin, duhet të përmbajë të paktën këto informacione:
 - 3.1. specifikimin e funksioneve shtetërore në fjalë dhe arsytet thelbësore për propozimin e ndryshimit, si dhe arsyetimin për vazhdimin e ndërhyrjes publike në këtë fushë (testi i interesit publik);
 - 3.2. vlerësimin e performancës të formës aktuale institucionale për kryerjen e funksionit në fjalë;
 - 3.3. analizën e formave institucionale në dispozicion për ushtrimin e funksioneve përkatëse, që çon në përzgjedhjen e llojit të propozuar të institucionit (testi i opsioneve për kryerjen e funksioneve);
 - 3.4. sqarimin dhe arsyetimin për ndryshimet e propozuara për organizimin e organit drejtues dhe mbikëqyrjen e performancës/veprimtarisë të institucionit, nëse janë të ndryshme nga ato të përcaktuara me këtë ligj;
 - 3.5. projektbuxhetin për vitin e parë buxhetor, duke përfshirë këtu specifikimin e kostove operative lidhur me themelimin e institucionit;
 - 3.6. projektplanin e performancës vjetore të organit të ri;
 - 3.7. kufijtë e numrit të punonjësve për vitin e parë buxhetor.

Neni 49

Bashkimi i agjencive ekzistuese

1. Nëse ligji i themelimit të një agjencie përcakton krijimin e një agjencie të re si pasojë e shkrirjes me bashkim apo shuarje e së paku dy (2) agjencive ekzistuese, përveç sa parashikohet në paragrafët 1 dhe 2 të neni 48 të këtij ligji, duhet të përmbajë edhe dispozita për:
 - 1.1. përcaktimin e të gjitha agjencive që bashkohen/shuhen;
 - 1.2. datën e bashkimit/shuarjes, dhe
 - 1.3. rregullimin e pasojave juridike për zyrtarët, pronën në administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të treta dhe procedurat administrative në vazhdim të agjencive që bashkohen/shuhen.
2. Rregullimi i pasojave juridike sipas nënparagrafit 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni duhet të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë dhe respektimin e interesave të zyrtarëve ekzistues dhe palëve të tjera të përfshira.
3. Memorandumi shpjegues, që shoqëron projektligjin për themelimin, përveç sa parashikohet në paragrafin 3 të neni 48 të këtij ligji, duhet të përmbajë edhe planin e tranzicionit, që përmban një listë të detyrave dhe afatin për të gjitha aktivitetet e natyrës organizative të nevojshme për të përfunduar procesin e riorganizimit.

Neni 50 Shuarja e një agjencie

1. *Shuarja e një agjencie përfshin likuidimin e agjencisë dhe tërheqjen nga funksionet që ajo ka kryer ose transferimin e të gjitha funksioneve ose pjesë të këtyre funksioneve tek institucione ekzistuese, qoftë një agjencie tjetër apo një ministrie.*
2. *Ligji mbi shuarjen e një agjencie duhet të përcaktojë:*
 - 2.1. *emrin e agjencisë që shuhet;*
 - 2.2. *funksionet dhe kompetencat e agjencisë së shuar, që nuk kryhen nga një institucion shtetëror;*
 - 2.3. *funksionet dhe kompetencat e agjencisë së shuar, që janë bartur te institucionet ekzistuese dhe përcaktimin e këtyre institucioneve;*
 - 2.4. *datën e shuarjes, dhe*
 - 2.5. *rregullimin e pasojave juridike për zyrtarët, pronën në administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të treta dhe procedurat administrative në vazhdim të agjencive që bashkohen/shuhen sipas paragrafit 2 të nenit 49 të këtij ligji.*
3. *Memorandumi shpjegues, që shoqëron projektligjin për themelimin, përveç sa parashikohet në pikën 3 të nenit 48 të këtij ligji, duhet të përmbajë edhe planin e tranzicionit, që përmban një listë të detyrave dhe afatin për të gjitha aktivitetet e natyrës organizative të nevojshme për të përfunduar procesin e riorganizimit.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

61. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmërinë të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
62. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
63. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë ngritur kërkesën e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.
64. Andaj, bazuar në të lartcekurat, një kërkesë e parashtruar para Gjykatës sipas paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, duhet (i) të parashtrohet nga së paku dhjetë (10) deputetë; (ii) të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, përkthazi me përmbajtjen dhe/ose procedurën e ndjekur; si dhe (iii) të parashtrohet brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit të aktit të kontestuar.
65. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të parë përkatësisht numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesat përkatëse, vëren se kërkesa është parashtruar nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit, numër ky i cili përmbush kriterin e përcaktuar përmes fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën.
66. Gjykata, gjithashtu në vlerësimin e përmbushjes së kriterit të dytë, vëren se parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Ligjin nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, i cili u miratua më 19 tetor 2023, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
67. Ndërsa sa i përket kriterit të tretë, përkatësisht afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se kërkesa është dorëzuar

përmes postës në Gjykatë më 27 tetor 2023, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 19 tetor 2023, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

68. Andaj, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës legjitimohen si palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, për të kontestuar kushtetutshmërinë e aktit të kontestuar para Gjykatës, pasi në rastin konkret, të njëjtit janë palë e autorizuar dhe rrjedhimisht, e kanë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi.
69. Përveç kritereve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Neni 42 (Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.

70. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli ka efekt suspenziv.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

71. Në kuptim të dy dispozitave të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesën e tyre përkatëse; (ii) kanë specifikuar Ligjin e kontestuar të Kuvendit; (iii) u janë referuar neneve specifike të

Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) kanë dorëzuar argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre.

72. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës përkatëse, Gjykata konstaton që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është e pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

73. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, respektivisht dhjetë (10) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar dhe për të cilin pretendojnë se është në kundërshtim me nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] dhe nenin 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës. Këto pretendime, në esencë dhe sipas sqarimeve të dhëna në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet dhe përgjigjet e palëve të interesuara para Gjykatës, kundërshtohen nga Zyra e Kryeministrit dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
74. Gjykata thekson se thelbi i çështjeve që parashtruesit e kërkesës i kanë ngritur, ndërlidhen me pretendimet sipas të cilave Ligji i kontestuar është në kundërshtim me nenin 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës, sepse nuk ka përcaktuar kushte të arsyeshme me ligj për shfrytëzimin e resurseve natyrore të Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilave Këshilli i themeluar përmes nenit 21 (Këshilli) të Ligjit të kontestuar mund të merr vendimet përkatëse; (i) është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse përmes nenit 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) të Ligjit të kontestuar, mundësohet përzgjedhja e veçantë të investitorit, duke krijuar mundësi arbitraret në përzgjedhjen e investitorit strategjik përmes një procedure të negociimit të drejtpërdrejtë nga ana e Këshillit të Investimeve dhe duke pamundësuar sigurimin e mjedisit të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik, sigurinë e pronës, si dhe duke cenuar të drejtën në trajtim të barabartë të të gjithë investitorëve si atyre të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm; (iii) është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike sepse përmes neneve 52 dhe 53 të Ligjit të kontestuar, shfuqizohen Ligji Nr.04/L220 për Investimet e Huaja dhe Ligji Nr. 05/L—079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, ndër tjerash, duke mos adresuar çështjen e fushëveprimit të dispozitave ligjore mbi investitorët e jashtëm dhe investitorët përfitues të statusit të investitorit strategjik të cilët ishin përfitues të dispozitave ligjore të shfuqizuara, për më tepër që me themelimin e Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve (AIE) dhe Agjencisë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK), si dhe shuarjen e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, zyrtarët publik të të njëjtës nuk kanë asnjë siguri juridike për sa i përket statusit të tyre të marrëdhënies së punës dhe sistemit të tyre.
75. Në anën tjetër, dhe siç është shtjelluar në hollësi në pjesën që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe kundër-argumentet përkatëse në komentet dhe përgjigjet përkatëse, Zyra e Kryeministrit, ndër të tjera, thekson që Ligji i kontestuar, (i) ngërthen në vete dispozita të cilat kanë për qëllim kryesor nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve në Republikën e Kosovës dhe se mbrojtja e investimeve nuk mund të jetë më pak e favorshme se ajo e paraparë me ligj; (ii) siguron ndalimin e diskriminimit ndaj investitorit dhe investimit, gjë e cila aplikohet edhe në statusin e investitorit strategjik veçse të fituar në bazë të ligjeve të shfuqizuara; (iii) përcakton barazinë dhe largon mundësinë e diskriminimit në trajtim; (iv) përcakton rregulla të qarta me të cilat udhëhiqet një Këshill

i Investimeve si organ shtetëror e që vepron në bazë të parimeve të transparencës, për dallim nga çështjet e pozitës dominuese apo monopolit, e cila paraqet abuzim në treg; (v) Divizioni për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik sipas Ligjit për Zyrtarët Publik bën sistematizimin e zyrtarëve në kuadër të administratës shtetërore në bazë të rregullave të shkruara e të publikuara brenda Ligjit për Zyrtarët Publik.

76. Përderisa, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ndër të tjera, theksoi se: (i) Gjykata duhet ta refuzojë kërkesën si qartazi të pabazuar për shkak se parashtruesit e kërkesës nuk kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet se Ligji i kontestuar është në kundërshtim me një dispozitë kushtetuese, duke specifikuar gjithashtu, ndër të tjera, se (ii) Ligji i kontestuar është në përputhje të plotë me frymën dhe shkronjën e Kushtetutës dhe se i njëjti nuk bie ndesh me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] si dhe pjesërisht është në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 marsit 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në BE; dhe (iii) Ligji i kontestuar nuk ka efekt retroaktiv, përmes të cilit asnjë e drejtë e fituar nuk cenohet apo kufizohet, përkundrazi i njëjti e avancoi infrastrukturën ligjore dhe institucionale në favor të investitorëve.
77. Gjykata më tej rithekson që parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Ligjin e kontestuar në tërësinë e tij, duke pretenduar mospërputhshmërinë e tij me Kushtetutën, por jo detyrimisht duke ofruar argumente konkrete përkritazi me të gjitha dispozitat e Ligjit të kontestuar veç e veç. Marrë parasysh argumentet e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata në vijim do të ia nënshtrojë vlerësimin të kushtetutshmërisë (i) nenit 21 (Këshilli) të Ligjit të kontestuar ndërlidhur me themelimin e Këshillit të Investimeve; (ii) nenit 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) të Ligjit të kontestuar ndërlidhur me mundësinë e përzgjedhjes së veçantë të investitorit; dhe (iii) neneve 52 (Dispozita kalimtare) dhe 53 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar ndërlidhur me shfuqizimin e Ligjit nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligjit nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe shuarjes së Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës dhe të drejtave të zyrtarëve të kësaj Agjencie.
78. Në këtë vijë argumentimi, Gjykata fillimisht do të shtjellojë: (i) parimet themelore të ekonomisë së tregut të lirë sipas Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës; (ii) për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, parimet relevante që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare dhe që ndërlidhen me ekonominë e tregut të lirë, përfshirë edhe parimet që burojnë nga praktika e Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias; dhe më pas (iii) do të aplikojë këto parime përgjatë vlerësimin të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar.

II. Parime të Përgjithshme

1. Ekonomia e Tregut me konkurrencë të lirë si vlerë e rendit kushtetues dhe bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës

79. Gjykata fillimisht vë në pah që e njëjta ka elaboruar parimet që ndërlidhen me ekonominë e tregut të bazuar në konkurrencë të lirë, si vlerë kushtetuese dhe bazament i rregullimit ekonomik të Kosovës në rastin [KO173/22](#), me parashtrues *Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg*, Aktgjykim i 24 nëntorit 2023.
80. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit e konkret, Gjykata rikujton që Kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës. Normat e parapara me Kushtetutë duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën ngase vetëm në atë mënyrë

nxirret kuptimi i saktë i tyre. Normat kushtetuese nuk mund të nxirren jashtë kontekstit dhe të interpretohen në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera. Çdo paqartësi e normave duhet të interpretohet në frymën e Kushtetutës dhe vlerave të saj (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 128; [KO72/20](#), parashtrues: *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, Aktgjykimin i Gjykatës i 28 majit 2020, paragrafi 549; dhe [KO100/22](#), parashtrues: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë* dhe [KO101/22](#), parashtrues: *Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Aktgjykimin i Gjykatës i 24 marsit 2023, paragrafi 153).

81. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që bazuar në nenin e parë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit], Republika e Kosovës është “*shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm*”. Përkufizimi “*demokratik*” i shtetit të Republikës së Kosovës, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, plotësohet përmes tri (3) dispozitave thelbësore kushtetuese, përkatësisht nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 7 [Vlerat] dhe nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës.
82. Së pari, neni 3 i Kushtetutës, ndër të tjera, saktëson që (i) Republika e Kosovës qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore; dhe (ii) ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Së dyti, neni 7 i Kushtetutës, saktëson që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. Ky nen, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithashtu mbështetet përmes (i) nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, bazuar në të cilin, ndër të tjera, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, dhe (ii) nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], sipas të cilit, ndër të tjera, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj dhe vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Në fund, dhe me rëndësi, neni 16 i Kushtetutës, saktëson që: (i) Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës dhe se ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë; (ii) Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare; dhe (iii) secili person dhe organ në Republikën e Kosovës, u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 130; [KO100/22](#) dhe [KO101/22](#), cituar më lartë, paragrafi 155).
83. Për rrethanat e rastit konkret relevante janë edhe dy kategori dispozitash të Kushtetutës, përkatësisht neni 10 [Ekonomia] dhe ato të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës. Së pari, neni 10 i Kushtetutës saktëson që ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës, duke përcaktuar kështu parimin e ekonomisë së tregut të lirë, i cili është bazë e rendit ekonomik të Republikës së Kosovës, dhe si i tillë karakterizohet me parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe konkurrencës së lirë. Së dyti, Kapitullin IX lidhur me marrëdhëniet ekonomike, përbëhet prej katër (4) neneve, respektivisht, nenit 119 [Parimet e përgjithshme], nenit 120

- [Financat publike], nenit 121 [Prona] dhe nenit 122 [Përdorimi i pasurisë dhe burimeve natyrore] në kontekst të parimeve themelore që përcaktojnë marrëdhëniet ekonomike në Republikën e Kosovës (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 131).
84. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që neni 119 i Kushtetutës përcakton parimet e përgjithshme lidhur me ekonominë e tregut, i cili duhet të lexohet dhe interpretohet në ndërlidhje me nenet 7 dhe 10 të Kushtetutës. Leximi i përbashkët i këtyre neneve, përcakton ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë si bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Ky nen, përkatësisht neni 119 i Kushtetutës, në dhjetë paragraf përcakton parimet e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike në Republikën e Kosovës (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 132).
85. Në vijim, Gjykata rithekson që neni 119 i Kushtetutës përcakton detyrimin e Republikës së Kosovës, që (i) të siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private sipas përcaktimeve të paragrafit të parë të tij; (ii) të ndalojë të gjitha veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj, sipas përcaktimeve të paragrafit të tretë të tij; dhe (iii) të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik sipas përcaktimeve të paragrafit pesë të tij. Përtej detyrimeve të lartcekura të Republikës së Kosovës, neni 119 i Kushtetutës, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithashtu përcakton që Republika e Kosovës (i) siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme, sipas përcaktimeve të paragrafit dy të tij; dhe (ii) promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe garanton mbrojtjen e konsumatorëve në pajtim me ligjin (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 133).
86. Për më tepër, Gjykata vë në pah që paragrafi 6 i nenit 119 të Kushtetutës, që garanton nxjerrjen e lirshme të fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit për investitorët e jashtëm, në pajtim me ligjin, synon të krijojë një klimë të favorshme për investimet e huaja duke siguruar që fitimet dhe kapitali i investuar mund të transferohen jashtë vendit pa pengesa të panevojshme. Rrjedhimisht, kjo dispozitë, gjithashtu, nënkupton se liria për nxjerrjen e fitimit dhe kapitalit do të rregullohet në përputhje me ligjin, duke vendosur kështu një kornizë ligjore të qartë dhe transparente për këto veprime. Një qasje e tillë, ndihmon në balancimin e nevojave të investitorëve me interesat kombëtare të Kosovës, duke siguruar që procesi të jetë në përputhje me detyrimet ligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, garantimi i nxjerrjes së lirshme të fitimit dhe kapitalit kontribuon në nxitjen e një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik dhe të besueshëm për investimet e huaja, duke promovuar zhvillimin ekonomik të Kosovës.
87. Sipas sqarimeve si më sipër, Gjykata rikujton që pushteti legjislativ ka kompetencën që përmes procesit të ligj-bërjes të përcaktojë parimet e përgjithshme të sistemit ekonomik, duke përfshirë kompetencën që përmes ligjit: (i) të sigurojë një mjedis të favorshëm për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private; (ii) të përcaktojë përjashtimet nga parimet e konkurrencës së lirë; (iii) të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik; dhe (iv) të garantoj mbrojtjen e konsumatorëve (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 134).
88. Më tej, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin që operatorët ekonomik kanë edhe cilësinë e personit juridik, dhe ndaj të cilëve bazuar në paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat

juridikë, për aq sa janë të zbatueshme. Rrjedhimisht, operatorët ekonomik gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, për aq sa janë të zbatueshme. Të njëjtat, mund të kufizohen vetëm në kriteret dhe kushtet e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, çdo ndërhyrje në këto të drejta, duhet (i) të jetë e “përcaktuar me ligj”; (ii) të “ndjek një qëllim legjitim”; dhe (iii) të jetë “proporcionale me qëllimin e ndjekur” (shih rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 135).

89. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson që ekonomia e tregut është vlerë e Republikës së Kosovës dhe çdo ndërhyrje e shtetit në këtë liri dhe vlerë, duhet të bëhet vetëm përmes ligjit dhe në përputhje me përcaktimet dhe kufizimet e përcaktuara me Kushtetutë (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 136).
90. Të njëjtat parime përkitazi me ekonominë e tregut burojnë edhe nga përkushtimi i Republikës së Kosovës që të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike siç është përcaktuar në preambulën e Kushtetutës së saj. Ky përkushtim i Republikës së Kosovës, është reflektuar edhe përmes miratimit të Ligjit nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës më 2 nëntor 2015, dhe e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Kjo marrëveshje ndërkombëtare, bazuar në nenet 16 dhe 19 të Kushtetutës së Kosovës, është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe ka epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës. E njëjta synon mbështetjen e Republikës së Kosovës për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, dhënien e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik dhe social, përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së dhe mbështetjen e Kosovës për të përfunduar tranzicionin drejt një ekonomie të tregut funksionale. Në këtë mënyrë, MSA-ja është një marrëveshje që ka krijuar një proces asociimi të palëve në funksion të stabilizimit dhe përgatitjes së Republikës së Kosovës për anëtarësimin eventual në BE (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 137).
91. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që përtej detyrimeve që burojnë nga nenet 16 dhe 19 të Kushtetutës, respektivisht, parimi i sundimit të ligjit i përfshirë në nenin 3 dhe 7 të Kushtetutës, ndër të tjera, përfshin edhe parimin e supremacisë së ligjit dhe respektimin e hierarkisë së ligjeve e parimin e sigurisë juridike. Këto parime kushtetuese, përcaktojnë që një ligj duhet të jetë jo vetëm në harmoni me Kushtetutën por edhe me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare dhe të cilat bazuar në Kushtetutë, kanë epërsi mbi ligjet. Më saktësisht, Gjykata thekson që respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Hierarkia e akteve normative, e sanksionuar në nenin 16 dhe 19 të Kushtetutës, respektivisht, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Bazuar në nenet 16 dhe 19 të Kushtetutës, Republika e Kosovës zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i radhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve (shih, rastin e Gjykatës: [KO173/22](#), cituar më lartë, paragrafi 138; shih, ndër të tjera, vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 14, datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese të cituar në Vendimin nr. 21 datë 18.04.2023, (V-21/23), paragrafi 91 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).
92. Në fund, duke marrë parasysh rëndësinë e parimeve që burojnë nga e drejta e BE-së, përkitazi me fushëveprimin e Rregullores (BE) 2019/452 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 19 mars 2019, për krijimin e një kornize për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE, si dhe detyrimeve respektive të reflektuara në MSA, në vijim, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të shtjellojë këto akte.

2. Ekonomia e Tregut bazuar në konkurrencë të lirë sipas rregullativës së BE-së, si dhe parimeve që burojnë nga Raportet e Komisionit të Venecias

93. Në vijim, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të shtjellojë: (i) parimet relevante sipas Rregullores 2019/452 për krijimin e një kornize për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE, e cila është transpozuar pjesërisht në ligjin e kontestuar; si dhe (iii) parimet që burojnë nga Opinionet e Komisionit të Venecias.
- (i) Parimet përkatëse sipas Rregullores (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019 për krijimin e një kornize për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE*
94. Më 10 prill 2019, Rregullorja e BE-së për shqyrtimin e investimeve të huaja hyri në fuqi dhe u bë plotësisht funksionale më 11 tetor 2020. Objektivat kryesore të Rregullores së Investimeve të Huaja Direkte (në tekstin në vijim: IHD) janë që të sigurojë një kuadër bashkëpunimi në mbarë BE-në ndërmjet shteteve anëtare dhe Komisionit dhe të vendosë kritere të përbashkëta për të identifikuar rreziqet që lidhen me blerjen ose kontrollin nga investitorët e huaj të aseteve strategjike që mund të kërcënojnë sigurinë ose rendin publik.
95. Rregullorja (BE) 2019/452 është grupi i parë i rregullave të nivelit të BE-së për të trajtuar çështjen e IHD-ve. Gjykata vëren se Rregullorja e BE –së, nuk synon harmonizimin e plotë të mekanizmave të kontrollit të IHD-ve në BE, as zëvendësimin e kontrollit të IHD në nivelin kombëtar me një mekanizëm shqyrtimi në nivelin e BE-së. Në vend të kësaj, ajo promovon bashkëpunimin, ndarjen e informacionit dhe një nivel minimum të transparencës në lidhje me kontrollin e IHD-ve midis Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare të BE-së. Në vijim, janë të shpërfaqura disa çështje të rëndësishme të Rregullores:

Cili është qëllimi i Rregullores?

Sigurimi i një kornize të BE-së për shqyrtimin e investimeve direkte nga vendet joanëtare të BE-së për arsye sigurie ose rendit publik. Pra, Rregullorja përcakton:

- (-) një mundësi për shtetet anëtare të BE-së që të kenë mekanizma transparentë, të parashikueshëm dhe jodiskriminues për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte (IHD), bazuar në siguri ose rend publik;*
- (-) procedurat e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit Evropian për IHD-të që mund të ndikojnë në sigurinë ose rendin publik;*
- (-) mundësia që Komisioni të nxjerrë opinione dhe shtetet anëtare të japin komente për këto investime.*

Pikat kryesore të Rregullores

Rregullorja nuk harmonizon sistemet kombëtare të shqyrtimit. Rrjedhimisht, asgjë nuk e pengon një shtet anëtar të BE-së që të vendosë nëse do të ketë apo jo një mekanizëm kombëtar të shqyrtimit, apo nëse do të ekzaminojë apo jo një IHD të caktuar.

Detyrimet për shtetet anëtare të BE-së:

- (-) mund të mbajë, ndryshojë ose miratojë mekanizmat e shqyrtimit të IHD-ve;*
- (-) mund të vendosin nëse do të kenë mekanizma të shqyrtimit të IHD-ve dhe nëse po, ata duhet: të sigurojnë që këta mekanizma të jenë transparentë, të mos bëjnë diskriminim ndërmjet vendeve jo anëtare të BE-së, të mbrojnë informacionin konfidencial dhe komercialisht të ndjeshëm dhe të veprojnë brenda afateve;*
- (-) lejojnë investitorët dhe kompanitë e huaja të apelojnë kundër vendimeve të shqyrtimit;*
- (-) të kenë masat e nevojshme për të identifikuar dhe parandaluar shmangien e mekanizmave të shqyrtimit dhe vendimeve të shqyrtimit,*
- (-) të njoftojnë Komisionin për mekanizmat ekzistues të shqyrtimit deri më 10 maj 2019 dhe të raportojnë çdo të ri brenda 30 ditëve nga momenti i aplikimit;*

- (-) duhet t'i dorëzojnë Komisionit çdo vit detajet e IHD-ve në territorin e tyre gjatë vitit të kaluar kalendarik deri më 31 mars;
- (-) duhet të caktojë pika kontakti për zbatimin e legjislacionit, në të njëjtën mënyrë si Komisioni.

Në vlerësimin e tyre të IHD-ve në bazë të sigurisë ose rendit publik, shtetet anëtare dhe Komisioni mund të marrin në konsideratë efektin e mundshëm të IHD-ve në:

- (-) infrastruktura kritike fizike ose virtuale, duke filluar nga energjia, transporti dhe mbrojtja deri te infrastruktura zgjedhore, financiare dhe infrastruktura të tjera;
- (-) teknologjitë kritike dhe artikujt me përdorim të dyfishtë, si inteligjenca artificiale, robotika, ruajtja e energjisë dhe bioteknologjitë;
- (-) furnizimet kritike, të tilla si energjia ose lëndët e para, dhe siguria ushqimore;
- (-) qasje në informacione të ndjeshme, duke përfshirë të dhënat personale;
- (-) liria dhe pluralizmi i medias; dhe
- (-) nëse investitori i huaj:
kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një qeveri jashtë BE-së, duke përfshirë organet shtetërore ose forcat e armatosura, ka qenë tashmë i përfshirë në aktivitetet që prekin sigurinë ose rendin publik të një shteti anëtar, paraqet rrezik serioz për t'u përfshirë në aktivitetet të paligjshme ose kriminale.

3. Parimet që burojnë nga raportet e Komisionit të Venecias “Bazat juridike të sistemit ekonomik gjatë periudhës së tranzicionit nga ekonomia e planifikuar në ekonomi të tregut” [CDL\(1994\)009e-restr](#), Strasburg, 28 shkurt 1994

96. Gjykata rikujton që Komisioni i Venecias, përmes raportit të vitit 1994 lidhur me bazën ligjore të sistemit ekonomik gjatë periudhës së tranzicionit nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut, identifikoi elementët kryesor të bazës ligjore të sistemit ekonomik gjatë periudhës së tranzicionit nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të tregut. Bazuar në këtë raport, dhe ndër të tjera, vendoset theks në rëndësinë e “njohjes formale të lirisë së veprimtarisë ekonomike, [...]” dhe më e rëndësishmja, “parimin e konkurrencës së lirë që bazohet në lirinë ekonomike dhe parimin e barazisë, i cili lidhet me konkurrencën ndërmjet individëve të ndryshëm dhe ndërmjet individëve dhe shtetit”.
97. Raporti i lartcekur i Komisionit të Venecias trajtoi gjithashtu rolet përkatëse të kushtetutës dhe legjislacionit në sferën ekonomike. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias, ndër të tjera, theksoi se edhe pse “[në sferën ekonomike] kushtetutat përbëjnë bazën e domosdoshme të sistemeve juridike dhe ekonomike të shteteve”, roli i tyre duhet të mbetet “modest pasi që ato nuk janë instrumente të përshtatshme për rregullimin e detajuar të parimeve që rregullojnë ekonominë e tregut”. Në këtë mënyrë, sipas mendimit të Komisionit, “[kushtetutat nuk duhet të përdoren për të vendosur rregulla dhe rregullore të hollësishme; kjo është më mirë të bëhet me legjislacion të zakonshëm]”. Kështu, në këndvështrimin e Komisionit të Venecias, çdo referencë në Kushtetutë për parimin e ndërhyrjes së shtetit në sferën ekonomike duhet të kufizohet në “një përjashtim nga parimi i lirisë ekonomike, i arsytuar nga interesi i përgjithshëm”. Masat kufizuese për lirinë ekonomike duhet të miratohen nga ligjvënësi dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Sipas raportit, kufizimet e lirisë ekonomike duhet të jenë: (i) “specifike dhe të kufizuara dhe duhet të arsyetohen nga interesi i përgjithshëm ose nevoja për të ruajtur rendin publik”; (ii) të parashikuara me ligj; dhe (iii) “të nevojshme, efektive dhe proporcionale me kërkesat dhe peshën e situatës”. Raporti shtjellon më tej rolin e legjislacionit në sferën ekonomike, duke thënë se ai duhet të “përkthejë në formë të detajuar parimet bazë të përcaktuara në kushtetutë”. Ai gjithashtu parashikon që ligji mund t'i mundësojë ekzekutivit të “hartojë rregulloret e detajuara” në bazë të udhëzimeve dhe parimeve të politikave të përcaktuara në ligjin përkatës.

III. Aplikimi i parimeve të lartcekura në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar

98. Në vijim dhe duke aplikuar parimet e përgjithshme të shtjelluara si më sipër, Gjykata do të bëjë: (i) vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 21 të Ligjit të kontestuar, për sa i përket themelimit të Këshillit të Investimeve; (ii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 35 të ligjit të kontestuar, për sa i përket mundësisë së përzgjedhjes së veçantë të investitorit; dhe (iii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 52 dhe 53 të Ligjit të kontestuar, për sa i përket parimit të sigurisë juridike që ndërlidhet me shfuqizimin e Ligjit nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligjit nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës dhe shuarjes së Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës dhe të drejtave të zyrtarëve të kësaj Agjencie.

1. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 21 të Ligjit të kontestuar

99. Gjykata fillimisht rikujton që parashtuesit e kërkesës pretendojnë që neni 21 i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenin 122 të Kushtetutës, sepse i njëjti nuk përcakton kushte të arsyeshme me ligj për shfrytëzimin e resurseve natyrore të Republikës së Kosovës, gjithashtu duke e kufizuar konkurrencën e lirë dhe duke mundësuar arbitraritet të Qeverisë, respektivisht të Këshillit të Investimeve në vendimmarrjen e tij.

100. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që në çështje të organizimit të sistemit ekonomik, shteti, respektivisht Qeveria dhe Kuvendi, kanë margjinë të gjërë të veprimit, gjithnjë në përputhje me sistemin e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, e cila është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht është i mishëruar si koncept ekonomik në Kushtetutën e Kosovës.

101. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vëren që Këshilli i Investimeve përmes nenit 21 të Ligjit të kontestuar i ka të përcaktuara kompetencat si në vijim:

Neni 21 (Këshilli)

4. Këshilli ushtron këto përgjegjësi:

4.1. miraton plane veprimi dhe raporte për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke u kushtuar vëmendje mënjanimit të barrierave për investimet, përmirësimit të mjedisit të veprimitarisë ekonomike, mundësive zhvillimore dhe përparësive krahasuese të Republikës së Kosovës;

4.2. nxjerr vendime për investimet strategjike sipas nenit 36 të këtij ligji;

4.3. publikon ftesa dhe negociacion marrëveshje lidhur me investimet strategjike sipas neneve 29 dhe 35 të këtij ligji;

4.4. përcakton masat, procedurat, afatet dhe detyrimet e autoriteteve publike lidhur me hartimin dhe zbatimin e projekteve të investimit strategjik;

4.5. mbikëqyr zbatimin e investimeve strategjike;

4.6. kërkon verifikim plotësues të investimeve dhe nxjerr vendime mbi vlerësimin plotësues sipas kapitullit VII të këtij ligji.

4.7. Kryen funksione të tjera lidhur me fushën e investimeve dhe eksporteve të përcaktuara me vendim të Qeverisë.

102. Gjykata thekson që ky nen përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Këshillit në fushën e investimeve dhe eksporteve në Republikën e Kosovës, përfshirë ndërlidhur me vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen lidhur me projektet për investime strategjike, por edhe miratimin e planeve të veprimit dhe raporteve për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke i kushtuar vëmendje, sipas dispozitave të Ligjit të kontestuar, mënjanimit të barrierave për investimet dhe përmirësimit të mjedisit të veprimitarisë ekonomike.

103. Në vijim, ndërlihur me çështjen e lartcekur, Gjykata gjithashtu rikujton që një kompetencë të tillë të ngjashme, e kishte përcaktuar edhe Ligji nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, i cili kishte autorizuar Komisionin Ndërmarrës për Investime Strategjike që të ushtrojë përgjegjësitë e tij, të cilat ndër të tjera kishin të bëjnë me: (i) vlerësimin e propozimeve për projekte strategjike; (ii) nxjerrjen e vendimit për themelimin e grupit operacional për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe zbatimin e çdo projekti individual për investime strategjike dhe emërimin e kryesuesit të grupit operacional; (iii) monitorimin e zbatimit të projekteve strategjike; (iv) vlerësimin dhe aprovimin e rekomandimeve të Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve drejtuar Qeverisë për nxjerrjen e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik, për refuzimin e propozimit për dhënien e statusit investim strategjik dhe për anulimin e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik; (v) negociimin me subjektin investues si dhe lidhjen e marrëveshjes për investime strategjike pas nxjerrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik.
104. Gjykata thekson që neni 21 i Ligjit të kontestuar përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Këshillit në fushën e investimeve dhe eksporteve në Republikën e Kosovës. Gjykata vlerëson se ky nen përputhet me qëllimin e gjerë të shtetit për të zhvilluar ekonominë dhe për të promovuar investimet dhe eksportet në vend. Këshilli ka përgjegjësi për miratimin e planeve të veprimit dhe raporteve për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve dhe eksporteve, duke i kushtuar vëmendje mënjanimit të barrierave për investimet dhe përmirësimit të mjedisit të veprimtarisë ekonomike. Kjo përshtatet me qëllimin e përgjithshëm të shtetit për të rritur konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, neni 21 i Ligjit të kontestuar përcakton përgjegjësitë e Këshillit në zbatimin dhe mbikëqyrjen e investimeve strategjike, duke hartuar masat, procedurat dhe afatet për projektet e investimit. Këto përgjegjësi ndihmojnë në sigurimin e një mjedisi të favorshëm për investitorët dhe në përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë.
105. Në kontekstin e kompetencave dhe përgjegjësi të Këshillit, Gjykata vë theks në nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, sipas të cilit Qeveria mundëson zhvillimin ekonomik të vendit. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Qeveria, është e kushtëzuar në respektimin e parimeve lidhur me ekonominë e tregut që burojnë nga Kushtetuta, përkatësisht: (i) respektimin e vlerave të Republikës së Kosovës, përfshirë ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë për operatorët ekonomik, sipas përcaktimeve të neneve 7 [Vlerat] dhe 10 [Ekonomia] të Kushtetutës, respektivisht; (ii) respektimin e përcaktimeve të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, sipas të cilit dhe ndër tjerash, Republika e Kosovës ka detyrimin që të përcaktojë mekanizmat përmes të cilave ajo siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private, siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme; dhe siguron që investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin; dhe (iii) të siguruarit që pasuritë natyrore e Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin, sipas përcaktimeve të nenit 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës.
106. Për më tepër, Gjykata rikujton që neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] i Kushtetutës përcakton që pasuritë natyrore, duke përfshirë ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe të tjera, gëzojnë mbrojtje të veçantë në pajtim me ligjin. Në këtë drejtim, ky nen përcakton të drejtat dhe detyrimet e popullit të Republikës së Kosovës për sa i përket përdorimit të resurseve natyrore si dhe përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, në kontekst të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar. Kjo përfshin vendosjen e zonave me interes të veçantë nga Kuvendi për garantimin dhe mbrojtjen e tyre të veçantë nga institucionet shtetërore. Gjithashtu, ky nen sqaron se kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksplotimin e pasurive me interes të veçantë për

Kosovën dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj, duke e autorizuar Kuvendin për të rregulluar këto çështje me ligj.

107. Gjykata gjithashtu sqaron që paragrafi 2 i nenit 122 të Kushtetutës, që përcakton mbrojtjen e veçantë të pasurive natyrore të Kosovës, ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre pasurive dhe burimeve natyrore në interes të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë siguron që pasuritë natyrore dhe asetet me rëndësi të veçantë të trajtohen me kujdes dhe mbrojtje të veçantë nga shteti. Ajo vendos një detyrim kushtetues që këto pasuri të gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë në pajtim me ligjin, duke nënkuptuar se legjislacioni duhet të përcaktojë mekanizmat dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre. Mbi këtë bazë, Kosova ka miratuar legjislacion relevant për pasuritë dhe burimet natyrore që gëzojnë mbrojtje të veçantë duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar në: (i) Ligjin nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës; Ligji nr. 08/L-145 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes; Ligji nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligji nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës; Ligji nr. 02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma; si dhe Ligjin nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit. Gjykata thekson që zbatimi i Ligjit të kontestuar, përtej detyrimeve që burojnë nga neni 122 i Kushtetutës, duhet të jetë në përputhje edhe me ligjet e lartcekura.
108. Duke aplikuar parimet kushtetuese si më sipër, Gjykata vlerëson që themelimi i një Këshilli të Investimeve, nuk rezulton të cenojë ekonominë e tregut të bazuar në konkurrencë të lirë, për më tepër që vendimmarrja e tij, i nënshtrohet garancive kushtetuese, përfshirë në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjeve tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës, përfshirë të drejtës në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, sipas përcaktimeve të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
109. Për pasojë dhe sipas sqarimeve të dhëna, Gjykata konstaton që neni 21 (Këshilli) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të nenit 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës.

2. Vlerësimi të kushtetutshmërisë së nenit 35 të Ligjit të kontestuar

110. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që neni 35 i Ligjit të kontestuar cenon parimin e barazisë para ligjit nga neni 24 i Kushtetutës, sepse i njëjti krijon mundësi për arbitraritet në procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik. Për më tepër, sipas parashtruesve të kërkesës, Ligji i kontestuar pamundëson sigurimin e mjedisit të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut; (ii) lirinë e aktivitetit ekonomik; dhe (iii) sigurinë e pronës publike dhe private; si dhe cenon (iv) të drejtën në trajtim të barabartë të të gjithë investitorëve si atyre të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm sepse e kufizon konkurrencën e lirë duke krijuar kushte për pozitë dominuese në treg përfshirë vendosjen e praktikave që e kufizojnë konkurrencën e lirë si njëri nga parimet themelore të marrëdhënieve ekonomike në Republikën e Kosovës.
111. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata e sjell në vëmendje nenin 35 të Ligjit të kontestuar, i cili ndër të tjera përcakton:

Neni 35 Përzgjedhja e veçantë e investitorit

1. Këshilli mund të publikojë ftesë për të përzgjedhur partnerin për zbatimin e investimit strategjik, sipas kriterëve vlerësues në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli mund të përzgjedhë me negociim të drejtpërdrejtë shoqërinë e besuar për propozues, zbatues ose partner për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese në përputhje me legjislacionin në fuqi. Është shoqëri e besuar shoqëria tregtare me reputacion të mirë dhe referenca të njohura ndërkombëtare për nga veprimtaria ekonomike, etika biznesore dhe qeverisja e avancuar korporative, të dëshmuara nga institucionet financiare dhe audituese.

3. Këshilli mund të lidhë marrëveshje paraprake me propozuesin, zbatuesin ose partnerin nga ky nen. Marrëveshja mund të zëvendësojë propozimin nga neni 33 i këtij ligji, por duhet të jetë në përputhje me kushtet e përgjithshme nga neni 24 i këtij ligji.

112. Gjykata vëren që bazuar në nenin 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) të Ligjit të kontestuar, përcaktohet që Këshilli mund të publikojë ftesë për të përzgjedhur partnerin për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese në përputhje me legjislacionin në fuqi.
113. Në këtë drejtim, në kontekst të legjislacionit në fuqi, Gjykata vëren që Ligji i Prokurimit Publik ka për qëllim të sigurojë një përdorim sa më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike. Ky qëllim përmbushet duke përcaktuar një sërë kushtesh dhe rregullash specifike që duhet të zbatohen nga të gjitha palët e përfshira në proceset e prokurimit publik. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Ligji i Prokurimit Publik përmban dispozita që synojnë të mbrojnë integritetin e përdorimit të fondeve publike përmes efikasitetit, transparencës dhe drejtësisë, duke përcaktuar qartë procedurat, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve të përfshira.
114. Në vijim, Gjykata vëren që përjashtimisht nga ky rregull i publikimit të ftesës për të përzgjedhur partnerin për zbatimin e investimit strategjik, përmes paragrafit 2 të nenit 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) të Ligjit të kontestuar, Këshilli mund të përzgjedhë me negociim të drejtpërdrejtë shoqërinë e besuar për propozues, zbatues ose partner për zbatimin e investimit strategjik, sipas kritereve vlerësuese të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm. Në këtë drejtim, Ligji i kontestuar përmes nenit 24 (Kushtet e përgjithshme) të tij, përcakton kushtet e përgjithshme për shpalljen e investimit strategjik, përfshirë ndërlidhur me punësimin, rritjen e prodhimit dhe të eksportit, zhvillimit rajonal dhe qëndrueshmërisë mjedisore dhe të cilat gjithashtu ndërlidhen me objektivat shtetërore të nenit 14 (Objektivat shtetërorë) që synohen të përmbushen përmes nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve dhe sektorëve prioritarë për investime në Republikën e Kosovës sipas përcaktimeve të nenit 15 (sektorët prioritarë) të Ligjit të kontestuar.
115. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që Këshilli mund të lidhë marrëveshje paraprake me propozuesin, zbatuesin ose partnerin nga ky nen. Marrëveshja sipas këtij neni mund të zëvendësojë propozimin e investimit strategjik, për sa i përket afateve të shqyrtimit nga ana e Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve (AIE) të përcaktuar në nenin 33 (afatet e shqyrtimit) të ligjit të kontestuar, por duhet të jetë në përputhje me kushtet e përgjithshme të nenit 24 (Kushtet e përgjithshme) të Ligjit të kontestuar, të cilat duhet të plotësohen për të shpallur investimin strategjik, përkatësisht:
- (i) projekti duhet të ndihmon në përmbushjen e objektivave shtetërore, ku prijnë: (a) rritja e prodhimit dhe eksportit; (b) nxitja e ekonomisë qarkore; (c) rritja e konkurrueshmërisë së industrisë vendore; (d) zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë; (e) fuqizimi i ekosistemit industrial; (f) aftësimi dhe punësimi i fuqisë punëtore; (g) fuqizimi i rinisë, gruas, komuniteteve jo shumicë dhe grupeve të marginalizuara; (h) qëndrueshmëria e lëvizjes së popullsisë; (i) angazhimi i diasporës; (j) zhvillimi rajonal; (k) qëndrueshmëria mjedisore;

- (ii) projekti duhet të *përkon në sektorët prioritarë* për investim në Kosovë, ku përfshihen: (a) industria prodhuese dhe përpunuese; (b) bujqësia; (c) teknologjia e informacionit dhe komunikimit; (d) arsimi dhe aftësimi, hulumtimi dhe inovacioni; (e) shëndetësia; (f) turizmi; (g) administrimi i ujërave te zeza dhe mbeturinave; (h) transporti; (i) energjia; (j) minierat;
 - (iii) propozuesi ka dëshmuar aftësinë financiare për ta zbatuar investimin;
 - (iv) projekti duhet të jetë në pajtim me kërkesat për dokumente dhe të dhëna për propozuesin dhe projektin investues strategjik sipas nenit 30 (Propozimi i investimit strategjik) të Ligjit të kontestuar;
 - (v) projekti duhet të jetë nënshtruar verifikimit plotësues nëse kërkohet sipas kapitullit VII të Ligjit të kontestuar dhe është dhënë vendim për autorizimin e investimit, sipas nenit 40 (Përcaktimi i verifikimit plotësues) të Ligjit të kontestuar;
 - (vi) Investimi strategjik duhet të arrijë vlerën së paku dhjetë (10) milionë euro.
 - (vii) Duhet të i jepet përparësi në përzgjedhje projektit që ka vlerë më të madhe dhe ndihmon më shumë në përmbushjen e objektivave shtetërore nga neni 14 i këtij ligji, sidomos objektivat e punësimit, rritjes së prodhimit dhe eksportit, zhvillimit rajonal dhe qëndrueshmërisë mjedisore.
116. Më tej, bazuar në nenin 16 (Lehtësirat) të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren që në kontekst të përmbushjes së objektivave shtetërore përmes investimit në sektorë prioritar, investitori mund të përfitojë një tërësi lehtësirash, e ku spikasin: (i) lehtësirat në import për qëllime të prodhimit ose përpunimit, siç mund të jetë importi i makinerisë, lëndës së parë, gjysmëproduktit ose produktit tjetër; (ii) lirim nga detyrimi i eksportit; (iii) subvencionim të pagës së shtetasit të Republikës së Kosovës që punësohet ose aftësohet sipas normave ligjore në fuqi; (iv) përkrahje për hulumtim dhe zhvillim; (v) përkrahje për blerjen e makinerisë për prodhim ose përpunim; (vi) përparësi në qasje në parqe industriale dhe teknologjike; (vii) përkrahje për qasje në financa; (viii) përkrahje për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga furnitorët vendorë; (ix) përkrahje përmes zvogëlimit të barrës administrative dhe mbulimit ose zvogëlimit të kostos administrative; (x) lehtësira të tjera të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
117. Bazuar në analizën e mësipërme, në kontekst të adresimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata së pari vë në pah që Ligji i kontestuar proklamon barazinë para ligjit të investitorëve të huaj, të cilët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime ligjore sikurse investitorët vendor. Më saktësisht, (i) bazuar në nenin 6 (Barazia para ligjit) të Ligjit të kontestuar, është përcaktuar barazia e të gjithë investitorëve para ligjit; (ii) bazuar në nenin 7 (Mbrojtja dhe siguria) të Ligjit të kontestuar, investitori dhe investimet gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi; (iii) bazuar në nenin 8 (Respektimi i të drejtave) të Ligjit të kontestuar, institucionet publike obligohen që të respektojnë të drejtat e investitorit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, duke (a) zhvilluar procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi; (b) duke vepruar në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me parimet e tjera procedurale; (c) duke dhënë mundësi të arsyeshme investitorit për të paraqitur fakte dhe argumente në procedurën administrative, për sa lejojnë natyra e procedurës dhe interesi publik; dhe (d) mundësimin e ushtrimit të mjeteve juridike sipas Kushtetutës dhe ligjit; ndërsa (iv) bazuar në paragrafin 2 të nenit 8 (Respektimi i të drejtave) të Ligjit të kontestuar, të drejtat e përcaktuara nga i njëjti mund të kufizohen në rast të cenimit të rendit publik, moralit, sigurisë shtetërore, shëndetit publik, mjedisit dhe legjislacionit në fuqi.
118. Gjykata thekson që të drejtat e lartcekura, burojnë gjithashtu nga Kushtetuta. Më saktësisht, neni 119 i Kushtetutës, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, gjithashtu përcakton që Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme, sipas përcaktimeve të paragrafit dy të tij. Për më tepër përmes paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], Gjykata sqaron që të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në

Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme, duke përcaktuar në vijim përmes nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Përfundimisht, Gjykata sqaron që çdo kontest ligjor që mund të rezultojë ndërlidhur me të drejtat e fituara të personave juridik, përkatësisht operatoreve ekonomik të vendit ose të jashtëm, i nënshtrohet të drejtës në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave sipas ligjeve të aplikueshme dhe përcaktimeve të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

119. Gjykata gjithashtu thekson që përafrimi i legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së është obligim ndërkombëtar që buron nga MSA-ja ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Rrjedhimisht, neni 74 i MSA-së mes Kosovës dhe BE-së përshkon obligimin e Kosovës për përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe të zbatimit efektiv të tij. Në këtë kontekst, fusha që mbulon Ligji i kontestuar, e cila konsiston në fushën e investimeve që ndërlidhet edhe me fushën e tregtisë, është një prej fushave prioritare të reflektuara në paragrafin 3 të nenit 74 të MSA-së. Kjo nënkupton që në fazat e hershme të përafrimit të legjislacionit, Kosova duhet të fokusohet në *“elementet thelbësore të acquis të BE në fushën e Tregut të Brendshëm, dhe në fushën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, si dhe në fushat e lidhura me tregti. Në fazën e mëtejshme, Kosova duhet të përqendrohet në pjesët e mbetura të acquis-it të BE-së.”* (shih nenin 74.3 të MSA-së ndemjet Kosovës dhe BE-së).
120. Gjykata gjithashtu rikujton që neni 98 (Nxitja dhe mbrojtja e investimeve) i MSA-së, përcakton detyrimin për palët kontraktuese, përkatësisht për Kosovën në njërën anë dhe BE-në në anën tjetër, që të përqendrohen në mbrojtjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja duke krijuar një klimë të favorshme për investimet private vendase dhe të huaja që është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Kosovës. Në këtë drejtim, ky nen i MSA-së gjithashtu përcakton detyrim për Republikën e Kosovës që të përmirësojë kornizën ligjore për të favorizuar dhe mbrojtur investimet.
121. Ligji i kontestuar, bazuar në nenin 1 (Qëllimi) të tij, përcakton si qëllim të ligjit: promovimin, përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve të qëndrueshme dhe eksporteve në Kosovë, përfshirë përcaktimin e sektorëve prioritar për zhvillim. Për më tepër, Ligji i kontestuar sipas dispozitave të tij, konkludon se është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 2019/452 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 marsit 2019 për themelimin e kornizës për verifikimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian. Një qasje të tillë të verifikimit të investimeve të huaja, Kosova e ka marrë nga legjislacioni i BE-së, përkatësisht nga transpozimi i pjesshëm i **Rregullores (BE) 2019/452** së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 19 mars 2019 për krijimin e një kornize për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në BE. Rregullorja në fjalë konsiston në sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare të BE-së, për të vendosur kritere të përbashkëta për identifikimin e rreziqeve që lidhen me blerjen ose kontrollin nga investitorët e huaj të aseteve strategjike që mund të kërcënojnë sigurinë ose rendin publik.
122. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vë theks se përmes Ligjit të kontestuar parashikohet mundësia e një verifikimi shtesë ose plotësues të investimit potencial, veçanërisht nëse investimi i synuar ose i kryer nga personi i huaj ka gjasa të prekë rendin publik ose sigurinë shtetërore. Kjo dispozitë reflekton përgjegjësinë e Këshillit për të siguruar se investimet strategjike janë në përputhje me interesat dhe prioritetet e vendit, duke përcaktuar masat e nevojshme për të mbrojtur sigurinë dhe stabilitetin e shtetit. Në kuadër të këtij verifikimi plotësues i kushtohet vëmendje të veçantë pajtueshmërisë me: (i) normat kundër shpëlarjes së parasë, investimeve *ofshore* dhe financimit të terrorizmit; (ii) legjislacionin përkatës për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare; (iii) në rast të tregtisë së padrejtë, Republika e Kosovës ka të drejtë të mbrojë resurset e veta shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës për tregti me jashtë.

123. Në veçanti, verifikimi plotësues i kushton një vëmendje të veçantë pajtueshmërisë me legjislacionin kundër shpëlarjes së parave, investimeve “*offshore*” dhe financimit të terrorizmit, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet ndërkombëtare. Po ashtu, Këshilli ka detyrimin të verifikojë përputhjen me legjislacionin për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare. Në rast të tregtisë së padrejtë, Ligji përcakton se Republika e Kosovës ka të drejtën të mbrojë resurset e saj shtetërore në përputhje me legjislacionin për tregtinë me jashtë. Rrjedhimisht, këto dispozita ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe integritetit të procesit të investimeve strategjike në Kosovë (shih nenin 40 të ligjit të kontestuar).
124. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh faktin që partnerët për zbatimin e investimeve strategjike përzgjidhen përmes një procesi publik, ndërsa që përjashtimisht përzgjedhja e partnerit për investime strategjike përmes procedurës së negociimit të drejtpërdrejtë i nënshtrohet kriterëve të përcaktuara në Ligjin e kontestuar, përfshirë dispozitave të aplikueshme të Ligjit për Prokurimin Publik, por edhe të drejtës në mjet juridik sipas përcaktimeve të neneve 32 [Mjeti Juridik] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, rezulton që në kontekst të nenit 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) të Ligjit të kontestuar, nuk janë cenuar garancitë e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu sqaron që ky vlerësim nuk nënkupton edhe ligjshmërinë dhe/ose kushtetutshmërinë e vendimmarrjes së Këshillit në kontekst të përzgjedhjes së veçantë të investitorit, e cila mund t'i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë nga gjykatat e rregullta dhe kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese sipas përcaktimeve të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.
125. Përfundimisht, sipas sqarimeve të dhëna më lartë, Gjykata konstaton që neni 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

3. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 52 dhe 53 të Ligjit të kontestuar

126. Gjykata fillimisht rikujton që pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me këtë çështje fokusohen në dy drejtime, përkatësisht (i)pretendimin që shfuqizimi i dy ligjeve, përkatësisht Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligjit Nr. 05/1-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, si rezultat i Ligjit të kontestuar, krijon pasiguri juridike për investitorët që kanë fituar statusin e investitorit strategjik; dhe (ii)pretendimin që me themelimin e dy agjencive të reja, përkatësisht Agjencinë e Investimeve dhe Eksporteve (AIE) dhe Agjencinë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK), duke shuar Agjencinë ekzistuese për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, krijohet pasiguri juridike për zyrtarët publik që janë pjesë e agjencisë e cila shuhet në kontekst të marrëdhënieve të tyre të punës.
127. Në kontekst të analizimit të pretendimeve konkrete të parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht sjell në vëmendje nenin 52 (dispozita kalimtare) dhe 53 (shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar:

Neni 52 Dispozita kalimtare

1. *Rregullimi dhe organizimi i AIE dhe AIPNK do të rregullohen me akte të veçanta nënligjore.*
2. *Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, i ushtron te gjitha*

kompetencat në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, deri në hyrje në fuqi të akteve nënligjore sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Me strukturimin e Agjencisë sipas këtij neni:

3.1 Ministria merr përsipër sistematizimin e shërbyesve civil.

3.2. AIE dhe AIPNK marrin secila përsipër përgjegjësitë, pronat nën administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të treta dhe procedurat administrative në vazhdim, lidhur me fushëveprimet e tyre.

Neni 53 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.

128. Gjykata gjithashtu vë në pah edhe nenin 18 të Ligjit të kontestuar i cili përcakton:

Neni 18 **Themelimi i agjencive**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK) e themeluar me Ligjin për Investime të Huaja shuhet dhe në vend të saj themelohen këto Agjenci:

1.1. Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve (AIE);

1.2. Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës (AIPNK).

129. Në bazë të vlerësimit të dispozitave të lartcekura, Gjykata sqaron që: (i) përmes nenit 53 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar, shfuqizohen dy ligje paraprake, përkatësisht, Ligji nr.04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligji nr.05/1-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës; ndërsa (ii) përmes nenit 52 (Dispozitat kalimtare) në ndërlidhje me nenin 18 (Themelimi i agjencive) të Ligjit të kontestuar shuhet Agjencia Për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës. Kjo e fundit, zëvendësohet nga dy Agjenci tjera, të themeluara bazuar në nenin 18 (Themelimi i Agjencive) të Ligjit të kontestuar, përkatësisht Agjencia e Investimeve dhe Eksporteve dhe Agjencia për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, funksionet, kompetencat dhe organizimi i të cilave është gjithashtu e përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar.

130. Fillimisht dhe ndërlidhur me pretendimet që shfuqizimi i dy ligjeve paraprake përmes Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat e fituara të investitorëve të huaj të fituara përmes ligjeve të shfuqizuara, Gjykata thekson që miratimi, ndryshimi dhe/ose shfuqizimi i ligjeve është në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas përcaktimeve të neneve 65 [Kompetencat e Kuvendit], 80 [Miratimi i Ligjeve] dhe 81 [Legjislacioni me Interes Vital] të Kushtetutës, gjithnjë në kushtin që janë respektuar vlerat e Republikës së Kosovës sipas përcaktimeve të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, i cili gjithashtu përfshinë edhe parimin e sigurisë juridike dhe kriterin e “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” së ligjeve.

131. Në këtë drejtim, Ligji i kontestuar është nxjerrë bazuar në autorizimet e lartcekura kushtetuese të Kuvendit dhe duke marrë parasysh përmbajtjen e dispozitave përfundimtare të Ligjit të kontestuar, në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton të jetë cenuar parimi i sigurisë juridike. Kjo, në parim, sepse (i) Me nenin 53 të Ligjit të kontestuar, qartazi përcaktohet që me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen Ligji Nr. 04/L-220 për

Investimet e Huaja dhe Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës; (ii) sipas paragrafit 2 të nenit 52 (Dispozita kalimtare) të Ligjit të kontestuar, Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, i ushtron të gjitha kompetencat në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, deri në hyrje në fuqi të akteve nënligjore të cilat përcaktojnë që rregullimi dhe organizimi i Agjencisë së Investimeve dhe Eksporteve si dhe Agjencisë për Inovacion dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, rregullohen me akte të veçanta nënligjore; (iii) për më tepër që, Ligji i kontestuar në nënparagrafin 3.2 të nenit 52 (Dispozita kalimtare), saktëson që agjencitë e themeluara përmes tij, marrin secila përsipër përgjegjësitë, pronat nën administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të treta dhe procedurat administrative në vazhdim, dhe për pasojë, çdo e drejtë e fituar bazuar në ligjet paraprake, i nënshtrohet garancive të Ligjit të kontestuar dhe për më tepër që, çdo kontest ligjor që mund të rezultojë ndërlidhur me të drejtat e fituara të personave juridik, përkatësisht operatoreve ekonomik bazuar në ligjet e shfuqizuara si më sipër, i nënshtrohet të drejtës në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave sipas ligjeve të aplikueshme dhe përcaktimeve të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

132. Në kontekst të vlerësimit të pretendimeve të lartcekura të parashtruesve të kërkesës, Gjykata e konsideron si të nevojshme të analizuarit e përmbushjes edhe të kriterëve të kërkuara nga *Lista Kontrolluese e sundimit të Ligjit*. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet aspektit të parashikueshmërisë së ligjeve, dhe në mënyrë specifike tek pyetja vijuese: A e përcakton qartë legjislacioni i ri nëse (dhe cili) legjislacion i mëparshëm është shfuqizuar apo ndryshuar? (Shih *Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit* [[CDL-AD\(2016\)007](#)] miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e 106 plenare, në Venedik, më 11-12 mars 2016, 3. Parashikueshmëria e ligjeve, fq.15).
133. Në përgjigje të pyetjes së parashtruar nga Lista kontrolluese e sundimit të ligjit, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar përmbush standardet e Listës Kontrolluese për sundimin e Ligjit, duke listuar në mënyrë të qartë ligjet që shfuqizohen të cilat përmenden në mënyrë të qartë. Një qasje e tillë në vlerësimin e Gjykatës, përveç që përkon me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga lista kontrolluese për sundimin e ligjit, e njëjta gjithashtu siguron transparencë dhe siguri juridike për investitorët, duke i ndihmuar ata të kenë njohuri të plota mbi ligjet e aplikueshme. Prandaj, Gjykata vlerëson se Ligji i kontestuar nuk sjell pasiguri juridike për investitorët strategjikë që kanë përfituar nga ligjet që ishin në fuqi, pasi që të njëjtit i bartin të drejtat dhe detyrimet në përputhje me ligjet respektive në kohën në të cilën të njëjtit kishin lidhur kontratë me shtetin e Kosovës. Rrjedhimisht, Ligji i kontestuar nuk ka efekt retroaktiv, ngase të gjitha kërkesat të cilat veçse janë parashtruar mbi bazën e dy ligjeve të shfuqizuara, përkatësisht Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja dhe Ligjit Nr. 05/1-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, do të trajtohen në bazë të këtyre dy ligjeve, përfshirë garancive që burojnë nga Kushtetuta.
134. Në anë tjetër dhe ndërlidhur me shuarjen e Agjencisë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Republikën e Kosovës, përfshirë statusin e zyrtarëve të saj publik, Gjykata sqaron që themelimi i Agjencive të Pavarura është në kompetencën e Kuvendit sipas përcaktimeve të neni 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës. Përtej garancive kushtetuese, sipas sqarimeve të dhëna, çështjet që ndërlidhen me themelimin, por edhe bashkimin dhe shuarjen e Agjencive, përfshirë atyre ekzekutive siç është rasti në rrethanat e Ligjit të kontestuar, janë të rregulluara përmes nenit 48 (Krijimi i një agjencie të re), nenit 49 (Bashkimi i agjencive ekzistuese) dhe nenit 50 (Shuarja e një agjencie) të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Ky i fundit, në kontekst të shuarjes së një Agjencie, përmes nënparagrafit 2.5 të nenit 50 (Shuarja e një agjencie) rregullon pasojat juridike ndërlidhur me zyrtarët përkatës publik, pronën në administrim, kontratat, detyrimet ndaj palëve të

treta dhe procedurat administrative në vazhdim të agjencive që bashkohen/shuhen. Për më tepër, paragrafi 2 i nenit 49 (Bashkimi i agjencive ekzistuese) përcakton që rregullimi i pasojave juridike duhet të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë dhe respektimin e interesave të zyrtarëve ekzistues dhe palëve të tjera të përfshira.

135. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se çështjet e ndërlidhura me shuarjen e një agjencie, në kontekst të adresimit të pasojave juridike që shkaktohen nga kjo shuarje, në mënyrën se si janë të normuara në Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore, janë të adresuara në mënyrë të duhur edhe në Ligjin e kontestuar.
136. Për më tepër dhe në kontekst të të drejtave të zyrtarëve publik të punësuar në agjencinë që shuhet, Ligji i kontestuar, në nenin 52 (Dispozita kalimtare), përcakton që Ministria përkatëse për Industrinë, Ndërmarrësinë dhe Tregtinë merr përsipër sistematizimin përkatës të shërbyesve civil sipas përcaktimeve të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Sipas sqarimeve të dhëna, ky sistematizim, i nënshtrohet garancive të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përfshirë të drejtës në mjete juridike dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, sipas përcaktimeve të vet Ligjit për Zyrtarët Publik, por edhe neneve 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
137. Për pasojë dhe sipas sqarimeve të dhëna më lartë, Gjykata konstaton se nenet 52 (Dispozita kalimtare) dhe 53 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme

138. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar nga Gjykata që të caktojë masë të përkohshme, me qëllim të parandalimit të zbatimit të Ligjit të kontestuar, deri në sjelljen e vendimit përfundimtar lidhur me kërkesat në fjalë.
139. Gjykata, në këtë kontekst, thekson se paragrafi 2 i nenit 43 [Afati] të Ligjit, e përcakton efektin pezullues të hyrjes në fuqi të ligjeve të cilat kontestohen në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton se *“Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendim i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*.
140. Bazuar në dispozitën e sipërpërmendur, më 21 nëntor 2023, Gjykata ka kërkuar nga Presidentja, Kryetari i Kuvendit, dhe Sekretari i Kuvendit të marrin parasysh kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit.
141. Prandaj, duke marrë parasysh se në bazë të paragrafit 2 të nenit 43 të Ligjit, Ligji i kontestuar, bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, apo të prodhojë efekte juridike para se Gjykata ta sjellë vendimin, si dhe në përputhje me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe rregullin 47 (Efekti suspenziv i kërkesave) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme është pa objekt të shqyrtimit dhe, si e tillë, refuzohet (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO100/22 dhe KO101/22, KO100/22, me parashtrues: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe KO101/22, me parashtrues: Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart), paragrafi 411, dhe Aktgjykimin në rastet KO216/22 dhe KO222/22, me parashtrues *Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë dhe KO220/22, me parashtrues: Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, (cituar më lart) paragrafi 405).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 113 (5) dhe 116 (2) të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 45, 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2024, njëzëri:

VENDOS


- I. TË SHPALLË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, që nenet 21 (Këshilli), 35 (Përzgjedhja e veçantë e investitorit), 52 (Dispozitat kalimtare) dhe 53 (Shfuqizimi) të Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2 të nenit 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës.
- III. TË REFUZOJË, kërkesën për masën e përkohshme;
- IV. TË SHPALLË që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji Nr.08/L-209 për Investime të Qëndrueshme, i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje;
- V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VI. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Enver Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani